

LIGJ
Nr. 74/2014

PËR ARMËT¹

(ndryshuar me ligjin nr. 152/2020, datë 17.12.2020; ligjin nr.75/2023, datë 14.9.2023)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti dhe fusha e veprimit

(ndryshuar shkronjat “a” dhe “ç” me ligjin nr. 152/2020, datë 17.12.2020)

Ky ligj rregullon:

- a) kushtet dhe kriteret për mbajtjen, ruajtjen, tregtimin, çaktivizimin, importimin, eksportimin, gjurmimin e transportimin e armëve, pjesëve kryesore e municioneve për përdorim civil, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, sipas këtij ligji;
- b) marrëdhëniet ndërmjet shtetit dhe subjekteve për pajisjen me armë e municione, kur një e drejtë e tillë ka lindur për shkak të pronësisë apo të detyrës;
- c) marrëdhëniet për lëshimin e licencave dhe autorizimeve nga Policia e Shtetit për çdo subjekt të interesuar për veprimtaritë e lejuara me armë, sipas kategorive të përcaktuara në këtë ligj;
- ç) veprimtarinë e prodhimit, demilitarizimit, çaktivizimit dhe riparimit të armëve.

Neni 2

Kufizime të fushës së veprimit

(ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 152/2020, datë 17.12.2020)

1. Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen për blerjen dhe posedimin e armatimit, pajisjet dhe municionet dedikuar për nevoja të strukturave të ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike, Ministrisë së Drejtësisë dhe Shërbimit Informativ të Shtetit ose koleksionistëve apo organizmave me karakter kulturor dhe historik në fushën e armëve, sipas përkufizimeve të këtij ligji.

2. Me përjashtim të rasteve kur ky ligj përcakton ndryshe, dispozitat e tij nuk zbatohen për transferimet ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe municioneve, importin, eksportin, tranzitin dhe veprimtaritë ndërmjetësuese të tyre, të cilat zhvillohen në bazë të ligjit për kontrollin shtetëror të

¹ Ky ligj është përafër me pjesërisht me direktivën e Këshillit 91/477/KEE, datë 18 qershor 1991, “Për kontrollin e blerjeve dhe posedimit të armëve”, numri CELEX: 31991L0477, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr. 256, datë 13.9.1991, faqe 51-58, e ndryshuar me direktivën 2008/51/KE, numri CELEX:32008L0051, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian Seria L, nr. 179, datë 8 korrik 2008, faqe 5-11.

transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë, si dhe për municionet dedikuar për nevoja të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

3. Licencimi i subjekteve shtetërore dhe private për këto veprimtari bëhet nga organet përgjegjëse të Ministrisë së Mbrojtjes, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 3

Përkufizime

(ndryshuar pikat 2, 3, 4, 5, 6, 9, 11, 13, 14, 20, 25, 29, 34, 42, 45, shtuar pikat 2/1, 3/1, 13/1, 48-71 me ligjin nr. 152/2020, datë 17.12.2020)

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Armë” konsiderohet çdo mjet ose vegël e përgatitur me qëllim që, nën presionin e gazrave, të cilat shkaktohen gjatë djegies së lëndëve shpërthyes, elektricitetit, gazrave, të hedhë predha në formë plumbi, grumbulli prej saçmash, gazi, lëngu, shigjete që shkaktojnë dëm fizik a psikologjik.

2. “Armë zjarri” është çdo armë e transportueshme, me tytë, që realizon, është projektuar për të realizuar ose që mund të modifikohet lehtësisht për të realizuar të shtënë me plumb ose predhë nëpërmjet veprimit të barutit, përveç rasteve të mëposhtme:

a) është projektuar për alarmimin, sinjalizimin, shpëtimin e jetës, therjen e kafshëve, peshkimin me fuzhnjë ose për qëllime industriale e teknike, me kusht që të përdoret vetëm për qëllimin e cituar;

b) konsiderohet si armë antike sipas përkufizimit të këtij ligji.

2/1. Një objekt konsiderohet i modifikuar për të realizuar të shtënë me plumb ose predhë nëpërmjet veprimit të barutit kur:

a) ka pamjen e një arme zjarri;

b) mund të modifikohet si rezultat i konstruksionit ose materialit nga i cili është prodhuar.

3. “Armë qitjeje sportive pneumatike” është çdo lloj arme me tytë, që realizon një shkrepje ose nxjerr jashtë një saçmë nëpërmjet veprimit të forcave që nuk janë krijuar nga djegia e barutit. Konsiderohet armë qitjeje/pneumatike çdo armë, predha e së cilës ka një energji të matur gjatë fluturimit, të barabartë ose më të lartë se 7,5 J.

3/1. “Armë të qitjes me kapacitet të reduktuar” janë:

a) armët, predhat e të cilave kanë energji të matur gjatë fluturimit më të ulët se 7,5 J;

b) armët me mbushje nga gryka, me një shkrepje;

c) armët e destinuara të nxjerrin jashtë sfera plastike, të cilat përmbajnë vetëm lëng njollosës.

4. “Armë zjarri e shkurtër” është arma me tytë me gjatësi deri në 30 centimetra ose gjatësia e përgjithshme e së cilës nuk i kalon 60 centimetra.

5. “Armë zjarri e gjatë” është çdo armë zjarri e ndryshme nga arma e zjarrit e shkurtër.

6. “Armë zjarri automatike” është arma e cila mbushet automatikisht dhe realizon shkrepje/të shtëna të pandërprera me një tërheqje të këmbëzës së shkrepjes.

7. “Armë gjysmautomatike e zjarrit” është arma e zjarrit që rimbushet në mënyrë automatike sa herë shkrepet fisheku dhe që mund të shkrepë vetëm një fishek me një tërheqje të këmbëzës.

8. “Armë të drejtura me energji (ADE)” është lloji i armës që çliron energji në një drejtim të shenjuar, pa përdorur predhën. Kjo armë e mbart energjinë të shënjestra për qëllim të efektit të dëshiruar.

9. “Armë zjarri përsëritëse” është çdo armë zjarri, e cila pas çdo të shtëne është prodhuar për t’u rimbushur manualisht nga krehëri apo nga cilindri.

10. “Armë zjarri me qitje një nga një” është arma e zjarrit pa karikator, e cila mbushet para çdo shkrepjeje, përmes futjes me dorë të fishekut në fole apo në hapjen për mbushje në të prerën e tytës.

11. “Armë pneumatike” është arma e prodhuar për hedhjen e saçmave nëpërmjet presionit të ajrit apo gazeve të ngjeshura. Këto armë ndahen në tre tipa sipas fuqisë së burimit të tyre:

- a) armë të cilat si burim fuqie përdorin bombola me dyoksid karboni të ngjeshur;
- b) armë të cilat si burim fuqie përdorin ajrin e ngjeshur nëpërmjet veprimit të një suste;
- c) armë të cilat si burim fuqie përdorin ajrin e ngjeshur nëpërmjet veprimit të një leve.

12. “Armë për përdorim të mjeteve të ndryshme” janë të gjitha llojet e pushkëve, pistoletave, revolverëve apo mjeteve të tjera të cilat, nën shtypjen e barutit ose të gazrave, përhapin në një drejtim gaz ngacmues që ka ndikim në shëndetin e njeriut.

13. “Armë për alarm dhe sinjalizim” është pajisja me mbajtëse fisheku e projektuar për të shkrepur vetëm fishekë manovre, substanca irrituese, substanca të tjera aktive ose fishekë piroteknike sinjalizues dhe që nuk mund të modifikohen për të realizuar një të shtënë, plumb ose predhë nga veprimi i barutit.

13/1. “Armë për sinjalizim akustik” është arma e zjarrit e prodhuar në mënyrë të veçantë vetëm për përdorimin e shkrepjes së fishekëve të manovrës, për përdorim në shfaqje teatrale, sete fotografike, prodhime filmike dhe televizive, rikrijime historike, parada, aktivitete sportive dhe stërvitje.

14. “Armë shpërthyes” nënkupton kryesisht çdo lloj bombe, mine, rakete, granate apo mjeti tjetër që përmban lëndë plasëse apo materiale ndezëse, ndaj të cilave, për shkak të proceseve të brendshme apo të jashtme (peshës, ndikimit, fërimit, reagimit kimik, energjisë elektrike dhe të ngjashme), shkaktohet lirimi apo krijimi i energjisë dhe shpërthimit.

“Armë shpërthyes”, gjithashtu, konsiderohen pjesët e eksplozivëve, detonatorët, mjetet piroteknike apo pjesët e tjera, për të cilat qartazi duket se janë të paracaktuara për përgatitjen e armëve shpërthyes. Ky përkufizim është i paracaktuar të përfshijë armët termobarike, të cilat dallohen nga armët konvencionale eksplozive, për shkak se funksionojnë me oksigjen atmosferik dhe nuk kanë oksidues në eksplozivët e tyre. Po ashtu, quhen armë termobarike me impuls të lartë (TIL), eksploziv karburant-ajër (EKA apo FAX), e nganjëherë quhen edhe municione karburant-ajër, armë me nxehtësi dhe shtypje apo bomba vakumike.

15. “Armët me harkose me tojë” janë harqet dhe mekanizmat e tjerë që funksionojnë nën shtypjen e fijes së shtrënguar, të cilat gjuajnë me shigjetë apo predhë tjetër.

16. “Armë e ftohtë” nënkupton një armë të ndryshme nga ajo e zjarrit ose e qitjes dhe konsiderohet çdo lloj instrumenti i përgatitur dhe i destinuar posaçërisht për sulm kundër personave ose për vetëmbrojtje. Ato mund të jenë me majë të tehtë, si: shpatat, shkopinjë-shpata, kamat, pinjallët, bajonetat, thikat, thikat me shkrepje dhe të ngjashme me to, dhe armë mprehëse ose me kontakt, si: shkopinjë e gomës, topuzët, dorezat metalike, trullësit elektrikë dhe të ngjashëm me to.

17. “Armë me elektrohok” është arma që konsiderohet si armë paaftësuese, e cila përdoret për qetësimin e personit apo të shtazës përmes elektrohokut, që shkaktën shok elektrik përmes kontaktit të drejtpërdrejtë dhe ka për qëllim pengimin e funksioneve të muskujve sipërfaqësorë.

18. “Armë për qëllime industriale” është arma e prodhuar për alarmim, sinjalizim, shpëtim të jetës, therje të kafshëve apo për peshkim me harpun, për qëllime industriale ose teknike, me kusht që ato të përdoren vetëm për qëllimin e sipërpërmendur.

19. “Armë zjarri për gjueti” është arma e zjarrit e prodhuar apo kryesisht e përdorur për gjueti të shtazëve, për qëllime të të ushqyerit ose për sport, e cila dallohet nga ato të kategorisë “A” apo nga armët që përdoren kryesisht për qëllime luftarake dhe që u përkasin kategorive “B” e “C”, përmes të cilave gjuetia lejohet në përputhje me dispozitat ligjore të zbatueshme për gjuetinë.

20. “Armë zjarri sportive” është arma e zjarrit e prodhuar apo kryesisht e përdorur për ngjarje specifike dhe të paracaktuara sportive, e cila u përket kategorive “B”, “C” që është në përputhje me dispozitat e veçanta që rregullojnë sportet e qitjes.

21. “Armë e koleksionit” është arma e çdo lloji, e cila ruhet për qëllime koleksioni.

22. “Armë relike” është arma që lidhet direkt ose indirekt me një ngjarje historike ose personalitet

publik, apo që lidhet me marrëdhënie afektive me mbajtësin e saj.

23. “Armë dekorative” nënkupton send në formë arme, por i prodhuar për qëllime dekorative, i cili nuk mund të përdoret si armë.

24. “Imitum arme” është mjete, dukja e jashtme e të cilit ngjason me atë të armës, por që nuk mund të përdoret si armë zjarri apo nuk mund të prodhohet pa ndonjë mekanizëm të nevojshëm të qitjes e as që mund të përshtatet për qitje.

25. “Armë zjarri antike” janë armët e zjarrit me mbushje nga gryka si dhe ato të modeleve të prodhuara para vitit 1899.

26. “Armë zjarri artistike” është arma e zjarrit, sipërfaqja e së cilës është përpunuar artistikisht, duke e bërë të ndryshme nga armët e tjera të të njëjtit model, por pa i ndryshuar të dhënat teknike të saj.

27. “Armë zjarri e rrallë” është arma e një modeli të caktuar, e cila ekziston vetëm në një ose në disa ekzemplarë.

28. “Armë ceremoniale” është arma si pjesë integrale e uniformës ceremoniale ose e paradës, sipas rregullores përkatëse të mbajtjes së uniformës.

29. “Pjesë kryesore të armëve” janë tyta, shtrati/djepi, mekanizmi i shkrepjes, mulliri, shuli, krehëri, të cilat, duke qenë se janë objekte të veçanta, përfshihen në kategorinë e armëve të zjarrit, tek të cilat janë montuar ose do të montohen.

30. “Pajisje e posaçme për armë të zjarrit” është çdo mekanizëm që është i prodhuar dhe i dedikuar për përmirësimin e konstruksionit (shabllonit) bazë të armës së zjarrit, e cila, përmes aplikimit të saj, e rrit performancën dhe cilësinë e përdorimit të armës së zjarrit, përveç shënjestrës optike.

31. “Zbutësi i zhurmës” është një pajisje që i bashkëngjitet tytës apo është pjesë e saj, me qëllim zvogëlimin e zhurmës dhe të flakës së krijuar nga qitja me armë zjarri.

32. “Shënjestra optike” është një pajisje e posaçme për armë të zjarrit apo për armë të ftohta, që është e prodhuar si mjet ndihmës për shënjestrim apo mjet optik dhe që përdoret si ndihmë në caktimin e shënjestrës, duke e udhëhequr syrin dhe duke e përshtatur atë me armën apo me mjetin tjetër që duhet të drejtohet nga shënjestra. Shënjestra optike mund të përdoret për të përmirësuar armët e gjuetisë dhe ato sportive, të cilat përdoren për qëllime përkatëse të autorizuar, sipas autorizimeve nga organi përgjegjës, siç është shoqata e qitjes apo ajo e gjuetisë.

33. “Përshtatësit e kalibrit apo të tytës” janë pajisje të dedikuara për përdorim në gjueti dhe në qitje sportive, të cilat futen në tytë, me qëllim ndryshimin e dimensionit apo kalibrit të tytës dhe armës së zjarrit, përmes të cilave arma e zjarrit nuk e ndryshon kategorinë ekzistuese, në përputhje me këtë ligj.

34. “Armë zjarri të çaktivizuara” janë armët e zjarrit, të cilat janë bërë të papërdorshme në mënyrë të përhershme për shkak të çaktivizimit, duke garantuar që të gjitha pjesët kryesore të tyre janë bërë përfundimisht jofunksionale dhe të pamundura për t’u hequr, zëvendësuar ose modifikuar në mënyrë të tillë që do të mundësonte riaktivizimin e armëve të zjarrit.

35. “Municion” është bashkimi i komponentëve, përfshirë gëzhhojnë, kapsollën, barutin, plumbin ose predhën, që përdoren në një armë zjarri. Përkufizimi përfshin, por, duke marrë parasysh avancimet teknologjike, nuk është i kufizuar në:

a) fishekun, që paraqet kombinimin në një njësi të vetme të gëzhhojës, plumbit, barutit dhe ndezësit (kapsollës);

b) plumbin, që është element i fishekut me gëzhhojë, në armët e kalibrit të vogël;

c) numrin e madh të predhave të vogla (saçme), qëllimi i të cilave është shkrepja e përnjëhershme me një të shtënë të vetme. Armët që mund të mbahen me dorë, të prodhuara për këtë lloj të municionit, janë kryesisht të njohura si pushkë gjuetie;

ç) plumbin e pushkës me ajër, që është predhë josferike, e paracaktuar për qitje nga pushka me ajër.

36. “Municioni me plumb blindshpues” është municioni i përgatitur për përdorim ushtarak, plumbi i të cilit është i destinuar për të depërtuar në metal apo në blind.

37. “Municioni me predhë eksplozive” është municioni i prodhuar vetëm për përdorim ushtarak, plumbi i të cilit përmban mbushje që shpërthen në momentin e goditjes apo që ka fitil të përcaktuar me kohë ose të vonuar, që rezulton me shpërthimin e municionit në kohën e paracaktuar.

38. “Municioni me plumba të ndezshëm” nënkupton, por nuk kufizohet në, municionin e prodhuar për përdorim ushtarak, plumbat e të cilit përmbajnë përzierje kimike të ndezshme, dhe mund të përfshijë municion që përmban metal të përzier ekzotermik e piroforik në formë të predhës, i prodhuar për ndezjen e objekteve.

39. “Municioni gjurmëlënës” është municioni që është i destinuar për të lënë gjurmë tymi apo ndriçimi gjatë trajektores për në takim me objektivin. Ky lloj municioni përdoret për të ndihmuar në korrigjimin e qitjes.

40. “Municioni për armët për përdorim të agjentëve kimikë” është municioni që përmban mbushje kimike në plumb, që ndikon në shëndetin e njerëzve apo të kafshëve.

41. “Armët e kombinuara të zjarrit” janë armët e zjarrit me më shumë tytë. Kombinimi i tytave mund të përbëhet prej tytave të vjaskuara dhe të pavjaskuara me kalibër të ndryshëm.

42. “Gjurmimi i armëve, i pjesëve të armëve dhe municionit” nënkupton gjurmimin sistematik të armëve të zjarrit dhe, sipas rastit, të pjesëve kryesore të tyre dhe municioneve nga prodhuesi te blerësi, me qëllim asistimin e autoriteteve kompetente në zbulimin, hetimin dhe analizimin e prodhimit dhe trafikimit të paligjshëm.

43. “Organi përgjegjës” është organi përkatës në përbërje ose varësi të Ministrisë së Mbrojtjes apo të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit që lëshon licencën/autorizimin, të përcaktuar sipas këtij ligji ose akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi.

44. “Poligon civil qitjeje” është një objekt i hapur ose i mbyllur, brenda së cilit mund të zhvillohen aktivitete të sigurta të qitjes me armë zjarri. Objekti mund të jetë i nëndheshëm ose mbi sipërfaqe, duhet të ndërtohet në përputhje me normat ambientale dhe urbanistike të zonës ku ngrihet, si dhe duhet të sigurojë që shkrehja të ndodhë pa rrezikun e daljes së predhave ose të kërcimit të tyre drejt pikës së origjinës së qitjes.

45. “Armë të paligjshme” janë armët, tek të cilat nuk figuron i shtypur numri i matrikullimit apo, nëse është i pranishëm, është zhvendosur me dashje ose bërë i palexueshëm. Konsiderohen gjithashtu, të paligjshme armët e kategorive “B”, “C” të këtij ligji, tek të cilat nuk figuron i shtypur emri ose marka e fabrikuesit dhe vula e shtetit (AL).

46. “Besueshmëria” është procesi i verifikimit të të dhënave të personit në raport me ato të regjistrave fizikë dhe elektronikë të të gjitha institucioneve shtetërore, i cili pasqyrohet në aktin administrativ të organit përgjegjës të Policisë së Shtetit.

47. “Ministri” është ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.

48. “Muze” është një institucion i përhershëm në shërbim të shoqërisë dhe zhvillimit të saj, i hapur për publikun, i cili blen, pranon dhurata, ruan, bën kërkime dhe ekspozon armë zjarri, pjesë kryesore ose municione për qëllime historike, kulturore, shkencore, teknike, edukative, trashëgimore ose argëtuese dhe që njihet si i tillë.

49. “Koleksionist” është personi, fizik ose juridik i dedikuar, që merret me mbledhjen dhe ruajtjen e armëve të zjarrit, të pjesëve kryesore ose të municioneve për qëllime historike, kulturore, shkencore, teknike, edukative ose trashëgimore dhe që njihet si i tillë.

50. “Tregtar” është çdo person fizik ose juridik, tregtia ose aktiviteti i të cilit lidhet plotësisht ose pjesërisht me:

a) prodhimin, tregtimin, këmbimin, riparimin, modifikimin ose transformimin e armëve të zjarrit apo të pjesëve kryesore;

b) prodhimin, tregtimin, këmbimin, modifikimin ose transformimin e municioneve.

51. “Licencë” është akti administrativ që i lëshohet personit fizik apo juridik nga organi kompetent i përcaktuar me këtë ligj, me të cilin i njihet e drejta për të ushtruar aktivitete që kanë të bëjnë me armë, pjesë të armës dhe me municione, në përputhje me kushtet e përcaktuara në të.

52. “Autorizim për mbajtje arme” është akti administrativ që i lëshohet personit fizik ose juridik nga organi kompetent i përcaktuar në këtë ligj, me të cilin i njihet e drejta e mbajtjes së armës, pjesëve të armës dhe municioneve.

53. “Autorizim për blerje arme” është akti administrativ që i lëshohet personit fizik ose juridik nga organi kompetent për blerje arme, pjesë arme dhe municione, në përputhje me kushtet e përcaktuara në të.

54. “Prodhim i paligjshëm” është prodhimi ose montimi i armëve të zjarrit, i pjesëve kryesore të tyre ose i municioneve:

- a) duke filluar nga çdo pjesë kryesore e këtyre armëve të zjarrit, të trafikuar në mënyrë të paligjshme;
- b) pa autorizimin e lëshuar nga autoritetet kompetente të shtetit ku bëhet prodhimi ose montimi; ose
- c) pa markimin standard në kohën prodhimit.

55. “Trafikim i paligjshëm” është importimi, eksportimi, tranzitimi, tregtimi, blerja, shitja, shpërndarja, lëvizja ose transferimi i armëve të zjarrit, i pjesëve kryesore të tyre ose i municioneve, me qëllim fitimin material ose çdo përfitim tjetër, nga ose nëpërmjet territorit të një shteti tjetër, nëse ky shtet nuk e autorizon atë në përputhje me këtë ligj, ose nëse armët e zjarrit, pjesët kryesore ose municionet nuk janë regjistruar në përputhje me nenin 10 të këtij ligji.

56. “Rezident” është personi, i cili konsiderohet i tillë dhe është i pajisur me dokument zyrtar që tregon vendbanimin e tij, si dhe identifikohet me pasaportë ose kartë identiteti, të cilat u paraqiten autoriteteve kompetente të një shteti ose një operatori ekonomik për verifikimin që bëhet gjatë blerjes ose mbajtjes së armës. Nëse adresa e personit nuk tregohet në dokumentin e identifikimit, vendbanimi i tij përcaktohet në bazë të një vërtetimi tjetër zyrtar, të njohur nga shteti ku bëhet blerja apo mbahet arma me autorizim.

57. “Transferim ndërkombëtar i armëve të zjarrit” është eksporti, eksporti i përkohshëm, importi, importi i përkohshëm, riekspori, ndërmjetësimi, tranziti ose ringarkimi nëpër territorin shtetëror dhe çdo transferim tjetër jashtë apo brenda këtij territori, në të cilin janë përfshirë subjekte të ndryshme.

58. “Eksport” është procedurë:

- a) eksporti në kuptim të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë;
- b) riekspori në kuptim të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë, pa përfshirë armët e zjarrit në tranzit.

59. “Person” konsiderohet personi fizik ose juridik, që kryen veprimtari sipas këtij ligji.

60. “Eksportues” është:

a) çdo person fizik ose juridik, në emër të të cilit paraqitet deklarata doganore e eksportit ose personi që në kohën kur pranohet deklarata ka kontratën me marrësin e ngarkesës në vendin e huaj dhe ka autoritetin që të vendosë për dërgimin e armëve të zjarrit jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë;

b) personi që ka autoritetin të vendosë dërgimin e armëve të zjarrit jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, kur nuk është lidhur asnjë kontratë eksporti, apo nëse mbajtësi i kontratës nuk vepron në emër të vetë atij;

c) pala kontraktuese e vendosur në Shqipëri, e cila eksporton armë zjarri, sipas kontratës në të cilën është bazuar eksporti, në emër dhe për llogari të një personi të vendosur jashtë territorit shtetëror.

61. “Deklaratë eksporti” është akti me anë të të cilit një person shpreh, në formë dhe mënyrë të parashikuar, vullnetin për të vendosur armët e zjarrit, pjesët dhe përbërësit kryesorë të tyre dhe municionin në procedurë eksporti.

62. “Import” është procedurë importi në kuptim të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë.

63. “Importues” është:

a) personi fizik ose juridik i licencuar, i vendosur në territorin e Republikës së Shqipërisë, në emër të të cilit bëhet një deklaratë importi, ose një person që në kohën e dhënies së licencës ka nënshkruar kontratë me marrësin e armëve të zjarrit brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë;

b) personi i autorizuar që të marrë armët e zjarrit brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, nëse nuk ka pasur kontratë për eksportin, apo nëse njëra nga palët në kontratë nuk vepron në emër të tij;

c) çdo person, i cili ka të drejtën për të çliruar armët e zjarrit në qarkullim të lirë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

64. “Deklaratë importi” është akti me anë të të cilit një person shpreh, në formë dhe mënyrë të parashikuar, vullnetin për të vendosur mallrat e kontrolluara nën procedurë importi.

65. “Tranzit” është transporti tokësor, detar, ajror dhe/ose transporti i kombinuar i armëve të zjarrit, pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre, në kuptim të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë, që hyjnë dhe kalojnë përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, me destinacion një vend jashtë Shqipërisë dhe pa ndërruar pronësinë e mallrave, përfshirë artikujt:

a) që ndodhen të magazinuara përkohësisht dhe që rieksporthen drejtpërsëdrejti nga ambientet e magazinimit të përkohshëm;

b) që janë sjellë në territorin e Republikës së Shqipërisë me të njëjtin mjet lundrimi apo fluturimi që do t'i nxjerrë ato jashtë atij territori, pa i shkarkuar dhe nga e njëjta pikë doganore;

c) që i nënshtrohen ringarkimit brenda për brenda.

66. “Ringarkim” është transferimi i ngarkesës nga një mjet transporti te një tjetër për tranzit të mëtejshëm për të përfunduar udhëtimin dhe për ta transportuar ngarkesën në destinacionin e fundit të saj, pa ndryshuar pronësinë e mallrave.

67. “Person përgjegjës për tranzitin” është:

a) personi fizik ose juridik i caktuar, i cili vendos për tranzitimin;

b) personi fizik ose juridik përgjegjës për transportin, i cili vepron nëse nuk ka person fizik apo juridik të caktuar.

68. “Eksport i përkohshëm i mallrave” konsiderohet lëvizja e armëve të zjarrit jashtë territorit doganor shtetëror, për t'u rikthyer në të njëjtin territor brenda 24 muajve.

69. “Ndërmjetësues” është çdo person fizik ose juridik i licencuar, i ndryshëm nga një tregtar dhe që kryen veprimtari ndërmjetësimi.

70. “Veprimtari ndërmjetësimi” është negociimi apo organizimi i transaksioneve për blerjen, shitjen ose furnizimin e armëve të zjarrit nga një vend në cilindo vend tjetër të huaj, ose blerja, shitja apo organizimi i transferimeve të armëve të zjarrit që ndodhen në një vend drejt një vendi tjetër.

Shërbimet ndihmëse nuk do të konsiderohen veprimtari ndërmjetësimi në kuptim të këtij ligji. Këto shërbime përfshijnë transportin, shërbimet financiare, sigurimin, risigurimin, si dhe reklamimin e përgjithshëm ose promovimin.

71. “Certifikata e përdoruesit të fundit” është dokumenti në të cilin përdoruesi i fundit përcakton vendin ku do të përdoren/mbahen armët e zjarrit, qëllimin përfundimtar të përdorimit, si dhe garanton se armët e zjarrit nuk do të përdoren për ndonjë qëllim të ndryshëm nga ai i specifikuar në certifikatë, nuk do të transferohen te ndonjë subjekt tjetër në territorin e vendit të destinacionit, ose nuk do të rieksporthen pa leje nga vendi eksportues.

Kjo certifikatë do të konsiderohet e vlefshme kur është paraqitur pranë autoriteteve brenda 6 muajve nga data e lëshimit.

Certifikata e përdoruesit të fundit lëshohet nga autoritetet përgjegjëse në rastet kur personat fizikë apo juridikë kanë si qëllim të pajisen me licencë importi dhe kur kërkohet nga shteti eksportues.

KREU II LLOJET DHE KATEGORITË E ARMËVE

Neni 4 Llojet e armëve

1. Sipas këtij ligji, llojet e armëve janë:
 - a) armët e zjarrit;
 - b) armët pneumatike (ajrore);
 - c) armët për përhapjen e gazrave irrituese;
 - ç) municionet shpërthyes;
 - d) armët me hark apo mekanizëm elastik;
 - dh) armët e ftohta;
 - e) armët për sinjalizim me dritë dhe me zë;
 - ë) paralizuesit elektrikë;
 - f) armët me drejtim energjetik;
 - g) si dhe lloje të tjera armësh, që do të njihen si të tilla nga aktet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj.
2. Njësohen me armët edhe municionet dhe pjesët kryesore përbërëse të armës, nëse në këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe. Ky kuptim i zgjeruar i termit “armë” vlen, ndër të tjera, edhe për licencat dhe autorizimet e parashikuara në këtë ligj.
3. Nuk njësohen si armë, sipas këtij ligji:
 - a) armët për qëllime industriale;
 - b) armët dekorative;
 - c) imitimet e armëve;
 - ç) armët, të cilat janë bërë të papërdorshme në mënyrë të përhershme (të çaktivizuara), përmes zbatimit të procedurave teknike, të cilat janë të garantuara apo të njohura nga organi përgjegjës;
 - d) harpunët për peshkim nën ujë.

Neni 5 Kategorizimi i armëve (ndryshuar me ligjin nr. 152/2020, datë 17.12.2020)

1. Armët, sipas këtij ligji, kategorizohen si më poshtë:
 - 1.1. Armët e kategorisë “A” janë:
 - a) predhat ushtarake plasëse dhe sistemet për lëshim (A1);
 - b) armët e zjarrit automatike (A2);
 - c) armët e zjarrit të kamufluara në formë të një mjeti tjetër (A3);
 - ç) municioni me shkallë të lartë depërtuese, municioni me predha shpërthyes, municioni me predha ndezëse, si dhe predhat për municion të tillë (A4);
 - d) municioni për pistoleta dhe revolver me predhë shpërndarëse dhe hapëse, si dhe predhat për municion të tillë, përveç në rastet e armëve për gjueti apo ato sportive të personave që kanë të drejtë t’i përdorin ato (A5);
 - dh) armë zjarri me zhurmëzbutës të montuar (A6);
 - e) armë zjarri me tytë të vjaskuar me kalibër mbi 12.7 milimetra (A7);
 - ë) mjete plasëse dhe pjesët e tyre (A8);

- f) armë për përdorim të agjentëve kimikë dhe municionit të tyre (A9);
- g) pajisja e veçantë për armë zjarri, e cila mundëson ndryshimin e saj në kategori tjetër (A10);
- gj) armë paralizuese elektrike (A11);
- h) municion blindshpues, gjurmëlënës, djegës (A12);
- i) armë e drejtuar me energji ADE (A13).

1.1.1. Armë zjarri automatike të modifikuara në armë zjarri gjysmautamatike me ndezje qendrore si më poshtë:

- a) armë zjarri e shkurtër, që shkrep më shumë se 21 fishekë pa rimbushje, nëse:
 - i. krehëri me kapacitet mbi 20 fishekë është pjesë e kësaj arme (A14);
 - ii. krehëri i çmontueshëm me kapacitet mbi 20 fishekë futet në këtë armë (A15);
- b) armë zjarri të gjata që shkrepin më shumë se 11 fishekë pa rimbushje, nëse:
 - i. krehëri me kapacitet mbi 10 fishekë është pjesë e kësaj arme (A16);
 - ii. krehëri i çmontueshëm me kapacitet mbi 10 fishekë futet në këtë armë (A17).

1.1.2. Armë zjarri të gjata gjysmautamatike, të cilat mund të reduktohen në një gjatësi nën 60 cm pa humbur funksionalitetin, me anë të një baze me palosje ose teleskopike, apo një baze që mund të hiqet pa përdorur vegla të tjera (A18).

1.1.3. Armë zjarri në këtë kategori, e cila është e modifikuar, funksioni i mëparshëm i të cilës ka qenë lëshimi i fishekëve të manovrës, substancave irrituese, fishekëve piroteknikë dhe sinjalizimi akustik (A19).

1.2. Armë zjarri të kategorisë “B”, për të cilat kërkohet autorizim, janë:

- a) armë zjarri të shkurtra me përsëritje (B1);
 - b) armë zjarri të shkurtra me një qitje, me ndezje qendrore (B2);
 - c) armë zjarri të shkurtra me një qitje, me ndezje anësore, me gjatësi të përgjithshme nën 28 cm (B3);
 - ç) armët e zjarrit të gjata gjysmautamatike me krehër dhe fole, që mund të mbajnë së bashku më shumë se 3 fishekë në rastin e armëve të zjarrit me ndezje anësore dhe më shumë se tre, por më pak se dymbëdhjetë fishekë, në rastin e armëve të zjarrit me ndezje qendrore (B4);
 - d) armë zjarri të shkurtra gjysmautamatike, që nuk janë përfshirë në shkronjën “a” të pikës 1.1.1 të kategorisë A (B5);
 - dh) armë zjarri të gjata gjysmautamatike të renditura në shkronjën “b” të nënpikës 1.1.1 të kategorisë “A”, me krehër dhe fole fishekësh që së bashku mund të pranojnë deri në tre fishekë, kur krehëri i tyre çmontohet, ose kur nuk është e sigurt që këto armë mund të modifikohen me mjete të zakonshme në një armë krehëri dhe foleja e fishekëve të së cilës pranon së bashku më tepër se tre fishekë (B6);
 - e) armë zjarri të gjata me përsëritje dhe gjysmautamatike me tytë të pavjaskuar, me gjatësi deri në 60 cm (B7);
 - ë) armë zjarri në këtë kategori, e cila është e modifikuar, funksioni i mëparshëm i së cilës ka qenë lëshimi i fishekëve të manovrës, substancave irrituese, fishekëve piroteknikë dhe sinjalizimi akustik (B8);
 - f) armë zjarri gjysmautamatike për përdorim civil, të ngjashme me armë me mekanizma automatikë, përveç atyre të renditura në pikat 1.1.1, 1.1.2 dhe 1.1.3 të kategorisë “A” (B9);
 - g) armë zjarri pneumatike, me energji të predhës mbi 7,5 J dhe kalibër mbi 4,5 mm (B7).
- 1.3 “Armë zjarri të kategorisë “C”, të cilat janë objekt autorizimi, si më poshtë:
- a) armë zjarri e gjatë me përsëritje, e cila nuk përfshihet në shkronjën “e” të pikës 1.2 të kategorisë “B” (C1);
 - b) armë zjarri të gjata me tytë të vjaskuar (C2);
 - c) armë zjarri e gjatë gjysmautamatike, që nuk përfshihet në kategorinë “A” ose “B” (C3);

ç) armë zjarri të shkurtra me një qitje me ndezje anësore, me gjatësi të përgjithshme jo më pak se 28 cm (C4);

d) armë zjarri në këtë kategori, e cila është modifikuar, funksioni i mëparshëm i së cilës ka qenë lëshimi i fishekëve të manovrës, i substancave irrituese, i fishekëve piroteknikë dhe sinjalizimi akustik (C5);

dh) armët e zjarrit të klasifikuara në kategorinë “A” ose “B” ose në këtë kategori, të cilat janë çaktivizuar në përputhje me standardet dhe teknikat e çaktivizimit të miratuara me rregullore;

e) armë zjarri e gjatë me një qitje me tytë të pavjaskuar (C7);

ë) armë pneumatike me energji të predhës deri në 7,5 J dhe kalibër deri 4,5 mm (C8).”.

1.4 Armët e kategorisë “D” janë:

a) armët e zjarrit antike (D1);

b) armët me hark apo me tojë (D2);

c) armët e ftohta (D3), të cilat ndahen në:

i) armë prodhim fabrike;

ii) armë artizanale.

Neni 6

Moscenimi i legjislacionit për armët ushtarake

Kategorizimi i armëve, sipas nenit 5, bëhet për qëllimet e këtij ligji dhe nuk cenon përcaktimet e legjislacionit në fuqi për armët dhe pajisjet ushtarake.

Neni 7

E drejta e pronësisë mbi armët

(ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 152/2020, datë 17.12.2020)

1. Armët e kategorisë “A”, në kuptim të këtij ligji, janë vetëm pronë e shtetit, me përjashtim të armëve të zjarrit për qëllime të shërbimeve të sigurisë, koleksionit, muzeut.

2. Armët e kategorive “B”, “C” dhe “D”, në kuptim të këtij ligji, mund të jenë në pronësi private e shtetërore.

3. Veprimet juridike për kalimin e pronësisë ose të të drejtave të tjera mbi armët kryhen në përputhje me kushtet dhe kërkesat e përcaktuara në këtë ligj.

4. Për sa nuk parashikohet në këtë ligj, zbatohen dispozitat e Kodit Civil.

Neni 8

Regjimi juridik për kategoritë e armëve

(ndryshuar me ligjin nr. 152/2020, datë 17.12.2020)

1. Në kategorinë “A” përfshihen armë të cilat nuk lejohen të përdoren dhe për të cilat nuk lëshohet autorizim.

1.1. Përjashtim nga pika 1, e këtij neni, bëhet vetëm për qëllime të sigurisë, të koleksionit dhe muzeve. Autoriteti kompetent pajis me autorizim për përdorim armë zjarri dhe pjesë kryesore të armëve të zjarrit të klasifikuara në kategorinë “A”, si më poshtë vijon:

a) shërbimet e sigurisë fizike lejohet të përdorin armë zjarri të kategorive “A16”, “A17”.

b) koleksionistët lejohet të përdorin armë zjarri të kategorisë “A”, që plotësojnë kriteret e armëve për koleksion, përjashtuar municionet. Autorizimi për këtë kategori lëshohet në raste individuale, në mënyrë përjashtimore dhe të argumentuar.

c) muzetë lejohen të përdorin armë zjarri të kategorisë “A”, për qëllime historike, kulturore, shkencore, teknike, edukative ose trashëgimore, përjashtuar municionet.

1.2. Subjektet fizike e juridike, sipas shkronjave “a”, “b” dhe “c”, të pikës 1.1 të këtij neni, pajisen me autorizim, me kusht që më parë të kenë garantuar masa për ruajtje e nivel sigurie të lartë, që është në raport me rreziqet që lidhen me aksesin e paautorizuar të këtyre artikujve.

1.3. Subjektet tregtare të licencuara lejohet të blejnë armë zjarri të kategorisë “A”, pjesë kryesore dhe municione, vetëm në rastet kur blihen për Forcat e Armatosura, Policinë e Shtetit, Ministrinë e Drejtësisë ose autoritetet publike.

1.4. Armët e zjarrit, pjesët kryesore dhe municionet e klasifikuara në kategorinë “A”, të mbajtura në mënyrë të paligjshme, konfiskohen.

2. Në kategorinë “B” përfshihen armë, për të cilat lëshohet autorizim si më poshtë:

a) lejohet të pajisen me autorizim për armë të shkurtra të kategorisë “B” personat që për shkak të detyrës shtetërore ose të rrethanave personale të veçanta janë të ekspozuar ndaj rrezikut për jetën dhe u njihet e drejta e mbrojtjes së veçantë, si dhe personat që plotësojnë kriteret për mbajtjen e armës;

b) lejohet të pajisen me autorizim për armë të shkurtra të kategorisë “B5” dhe armë të gjata të kategorisë “B” subjektet që për shkak të veprimtarisë së sigurisë fizike u lind e drejta e mbajtjes së armës sipas këtij ligji;

c) lejohet të pajisen me autorizim për armë të shkurtra të kategorisë “B” dhe armë zjarri të gjata me ndezje anësore “B4” qitësit sportivë.

3. Në kategorinë “C” përfshihen armët me cilësi teknike të kufizuara, për të cilat lëshohet autorizim nga Policia e Shtetit për shtetasit shqiptarë dhe të huaj, për qëllime gjuetie dhe sportive, sipas dispozitave të këtij ligji. Për armët e kategorisë “C” me vjaska lëshohet autorizim nga drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, në raste individuale në mënyrë të argumentuar.

4. Për armët e koleksionit të kategorive “B” e “C”, që plotësojnë kriteret për t’u quajtur armë zjarri dhe që plotësojnë kriteret e armëve për koleksion, lëshohet autorizim nga organi përgjegjës i Policisë së Shtetit.

5. Municionet, pjesët kryesore të armëve të zjarrit, pajisjet mbushëse të armëve gjysmautematike (krehërave), që mund të mbajnë më shumë se 20 fishekë ose më shumë se 10 fishekë në rastin e armëve të gjata të zjarrit, shiten njëllor si armët e zjarrit vetëm për personat që kanë autorizim për mbajtje arme zjarri përkatëse.

6. Brenda territorit të vendit të huajt rezidentë mund të blejnë një armë zjarri të klasifikuar në kategoritë “B” e “C” vetëm me autorizim. Një autorizim i tillë i jepet një shtetasi të huaj rezident me miratimin paraprak të vendit të tij. Shtetasi i huaj verifikohet periodikisht për përmbushjen e kushteve për mbajtjen e armës, për afatet maksimale të përcaktuara në këtë ligj.

7. Armët për alarm dhe sinjalizim shiten me autorizimin përkatës të lëshuar nga struktura përgjegjëse e Policisë së Shtetit.

Neni 8/1

Arsyet për blerjen e armës

(shtuar me ligjin nr. 152/2020, datë 17.12.2020)

1. Arsyet për blerjen e armës, pjesëve të armës dhe municionit nga personi fizik janë vetëm për mbrojtje fizike, gjuhë, sportin e qitjes ose për qëllime koleksioni, të cilat vendosen në kërkesën e aplikuesit për blerje arme.

2. Rastet e veçanta të mbrojtjes së sigurisë fizike, për të cilat lejohet blerja e armës sipas pikës 1 të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Arsyet për blerjen e armës, të pjesëve të armës dhe të municionit nga personi juridik janë për import, trajnime në poligone të licencuara, qitjen sportive, shërbime sigurie, koleksionim, muze, xhirime filmi.

Neni 8/2

Rastet për mbrojtje fizike

(shtuar me ligjin nr. 152/2020, datë 17.12.2020)

1. Personi mund të blejë dhe mbajë armë për mbrojtjen fizike kundrejt pajisjes me autorizim për blerje/mbajtje arme në vendbanim dhe mbajtje arme në lëvizje nga organi përgjegjës i Policisë së Shtetit.

2. Mbrojtja fizike, për shkak të rrezikut të aktivitetit shtetëror ose rrethanave personale të veçanta, i jep të drejtën personit të kërkojë të pajiset me autorizim të posaçëm për mbajtje arme në lëvizje.

3. Vlerësimi i rrezikut për jetën shqyrtohet nga komisioni qendror për vlerësimin e rrezikut të personave në Policinë e Shtetit, sipas përcaktimeve të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 9

Regjimi për hyrjet dhe daljet e armëve në territorin e Republikës së Shqipërisë

(shtuar pikat 8, 9 e 10 me ligjin nr. 152/2020, datë 17.12.2020)

1. Hyrjet dhe daljet në territorin e Republikës së Shqipërisë të armëve të kategorive “B” dhe “C”, të municioneve të tyre, për veprimtarinë e tregtimit, importit, eksportit, të gjuetisë, qitjes sportive, lejohen vetëm me autorizim të lëshuar nga organi përgjegjës i Policisë së Shtetit.

2. Në kuptim të këtij ligji, shtetasit e huaj, që kanë të drejtë të hyjnë me armë zjarri në territorin e Republikës së Shqipërisë, pajisen me autorizim të përkohshëm, të lëshuar nga organi përgjegjës i Policisë së Shtetit.

3. Armët, të cilat hyjnë dhe dalin nga territori shtetëror, kontrollohen dhe regjistrohen nga shërbimi doganor dhe Policia e Shtetit.

4. Për të gjitha armët e futura në mënyrë përfundimtare në territorin e Republikës së Shqipërisë, personi fizik ose juridik duhet të paraqitet në strukturat e policisë vendore, me qëllim vendosjen e vulës vërtetuese të hyrjes.

5. Vula e hyrjes përbëhet nga shënuesi identifikues i shtetit shqiptar “Albania”, i ndjekur nga sigla “AL” dhe nga viti i hyrjes.

6. Vulosja nuk është e nevojshme për armët e ardhura nga Bashkimi Evropian, mbi të cilat një shtet tjetër anëtar ka vendosur një vulosje të ngjashme.

7. Procedurat e hollësishme për mënyrën e hyrjes/daljes, vulosjes së armëve dhe regjistrimit të shtetasve shqiptarë e të huaj me armë të kategorive “B” dhe “C” në territorin e Republikës së Shqipërisë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

8. Armët e zjarrit dhe pjesët kryesore të tyre, të importuara nga Bashkimi Evropian, duhet të kenë mbi to të shënuar një markim të dukshëm, të përhershëm dhe unik.

9. Markimi unik përfshin emrin e prodhuesit ose markën, shtetin ose vendin e prodhimit, numrin e serisë dhe vitin e prodhimit, si dhe modelin nëse nuk është pjesë e numrit të serisë.

10. Municionet e prodhuara e të importuara detyrimisht duhet të përmbajnë markimin e plotë në çdo pako, në mënyrë të tillë që të tregojnë emrin e prodhuesit, numrin e identifikimit të partisë (lotit), kalibrin dhe llojin e municioneve.

Neni 10
Regjistrimi i armës së zjarrit
(ndryshuar me ligjin nr. 152/2020, datë 17.12.2020)

1. Për regjistrimin e armëve të zjarrit, pjesëve kryesore të tyre dhe municionet, personi fizik ose juridik, i autorizuar apo i licencuar, paraqitet në organin përgjegjës të Policisë së Shtetit ku ka vendbanimin ose ushtron aktivitetin, me dokumentet përkatëse të blerjes/shitjes, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes në pronësi të tyre.

2. Regjistrimi i armëve, i pjesëve kryesore e municioneve të tyre bëhet në format elektronik në sistem të informatizuar, i cili menaxhohet nga Policia e Shtetit. Sistemi i informatizuar i menaxhimit të armëve u lejon akses strukturave të Policisë së Shtetit, prokurorisë dhe gjykatës.

3. Sistemi i ruajtjes së të dhënave regjistron të gjitha informacionet për armët e zjarrit të nevojshme për t'i gjurmuar dhe identifikuar ato, duke përfshirë:

a) llojin, markën, modelin, kalibrin, numrin e serisë së çdo arme zjarri dhe markimin e vendosur në pjesën kryesore për çdo armë zjarri;

b) numrin e serisë ose markimin unik të vendosur në pjesët kryesore të çdo arme zjarri, në rastin kur ndryshon nga markimi në skeletin ose djepin e armës së zjarrit;

c) emrat dhe adresat e furnitorëve dhe të personave që blejnë ose mbajnë një armë zjarri, së bashku me datën ose datat përkatëse;

ç) çdo modifikim që i bëhet armës së zjarrit dhe që çon në ndryshimin e kategorisë apo nënkategorisë së saj, duke përfshirë çaktivizimin ose shkatërrimin e certifikuar të saj, si dhe datën ose datat përkatëse.

4. Sistemi i informatizuar i menaxhimit të armëve ndërtohet në mënyrë të tillë që të garantojë masat për sigurinë e të dhënave personale, parimin e mjaftueshmërisë dhe të proporcionalitetit për përpunimin e të dhënave, si dhe evidentimin e gjurmimit të të dhënave.

5. Të dhënat për armët e zjarrit dhe pjesët kryesore, të përmendura në pikën 3 të këtij neni, si dhe të dhënat personale përkatëse mund të aksesohen nga autoritetet kompetente:

a) për lëshimin ose revokimin e autorizimeve e licencave për një periudhë prej 10 vjetësh pas shkatërrimit të armës së zjarrit ose pjesëve kryesore në fjalë;

b) për parandalimin, hetimin, zbulimin ose ndjekjen penale të veprave penale ose ekzekutimin e dënimeve penale për një periudhë prej 30 vjetësh pas shkatërrimit të armës së zjarrit ose pjesëve kryesore në fjalë.

6. Të dhënat personale fshihen nga sistemi i ruajtjes së të dhënave pas përfundimit të periudhave të specifikuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 5 të këtij neni. Kjo do të bëhet pa cenuar rastet kur të dhëna personale specifike janë transferuar te një autoritet kompetent për parandalimin, hetimin, zbulimin ose ndjekjen penale të veprave penale ose ekzekutimin e dënimeve penale dhe përdoren në atë kontekst specifik, ose tek autoritete të tjera kompetente për një qëllim të përshtatshëm të parashikuar nga legjislacioni i brendshëm. Në këto raste përpunimi i këtyre të dhënave nga autoritetet kompetente do të kryhet në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

7. Gjatë gjithë periudhës së veprimtarisë së tyre, tregtarët dhe ndërmjetësit e armëve të zjarrit e të gjahut janë të detyruar të mbajnë regjistër, ku të regjistrohet çdo armë zjarri dhe pjesë kryesore, që është objekt i këtij ligji dhe që merret ose asgjësohet prej tyre, së bashku me detajet që mundësojnë identifikimin dhe gjurmimin e armës së zjarrit, ose pjesëve kryesore, në veçanti të llojit, markës, modelit, kalibrit dhe numrit të serisë, emrat dhe adresat e furnizuesve dhe të blerësve. Pas

përfundimit të aktiviteteve të tyre, tregtarët dhe ndërmjetësit dorëzojnë regjistrin tek organi përgjegjës i Policisë së Shtetit, që është përgjegjës për sistemet e ruajtjes së të dhënave.

8. Operatorët ekonomikë dhe ndërmjetësit duhet t'i raportojnë organit përgjegjës të Policisë së Shtetit transaksionet që përfshijnë armët e zjarrit ose pjesët kryesore dhe municionet, pa vonesa të pajustificuara, në çdo rast dhe sa herë kërkohet. Komunikimi i operatorëve ekonomikë dhe ndërmjetësve bëhet në formë shkresore ose elektronike.

9. Rregullat për krijimin, aksesin, funksionimin dhe administrimin e regjistrit elektronik të armëve, pjesëve kryesore dhe municioneve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 11

Qitja eksperimentale

1. Organi përgjegjës vendor i Policisë së Shtetit, pas regjistrimit të armës, kryen qitje eksperimentale dhe administron gëzhoja të përfituara për çdo armë të regjistruar.

2. Rregullat, procedurat dhe formulari që plotësohet në kohën e realizimit të qitjes eksperimentale dhe administrimi i gëzhojës në një bankë të dhënash përcaktohen me udhëzim të ministrit.

KREU III

VEPRIMTARITË E LEJUARA ME ARMËT

Neni 12

Kuptimi i veprimtarive të lejuara me armët

(shtuar fjalë në pikat "a" dhe "e" me ligjin nr. 152/2020, datë 17.12.2020)

Në kuptim të këtij ligji, me veprimtari të lejuara me armët kuptojmë:

- a) tregtimin, importin, eksportin, ndërmjetësimin, tranzitin;
- b) transportin brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
- c) aftësimin në poligon civil qitjeje;
- ç) aftësimin teorik e praktik të personave për armën;
- d) dhënien e armëve për përdorim kinematografik e skenik;
- dh) rimbushjen e municioneve;
- e) prodhimin, çaktivizimin, demilitarizimin e riparimin e armëve;
- ë) koleksionimin e armëve.

Neni 13

Licencimi

(ndryshuar me ligjin nr. 152/2020, datë 17.12.2020)

Licencimi i veprimtarive të lejuara me armë përfshin:

- a) regjistrimin e operatorëve ekonomikë dhe të ndërmjetësve, që veprojnë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;
- b) licencimin për të drejtën e fillimit të ushtrimit të aktiviteteve të operatorëve ekonomikë dhe të ndërmjetësve brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;
- c) autorizimin për kryerjen e një ose disa aktiviteteve të operatorëve ekonomikë dhe të ndërmjetësve brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;
- ç) kontroll të besueshmërisë dhe të aftësive përkatëse të operatorit ekonomik ose ndërmjetësit në

fjalë. Në rastin e një personi juridik, kontrolli do të kryhet si për subjektin juridik, ashtu dhe për personat fizikë që menaxhojnë sipërmarrjen.

Neni 14

Llojet e licencave

(ndryshuar me ligjin nr. 152/2020, datë 17.12.2020; ndryshuar shkronja "dh" e pikës 1 me ligjin nr.75/2023, datë 14.9.2023)

1. Në kuptim të këtij ligji, llojet e licencave janë:

- a) licencë për import/eksport, ndërmjetësim, tranzit, prodhim dhe demilitarizim për armët e kategorive "A" dhe "B", pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre;
- b) licencë për transportin e armëve, pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre;
- c) licencë për poligon civil qitjeje të hapur, të mbyllur, me pjatel;
- ç) licencë për aftësimin teorik dhe praktik të personave për armën;
- d) licencë për çaktivizimin e armëve të zjarrit për përdorim civil;
- dh) licencë për tregtimin e armëve të kategorisë "B" dhe për import dhe tregtim të armëve të kategorive "C" (gjahut) dhe "D" (sportive), pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre.

2. Licenca e prodhimit dhe e demilitarizimit, e përcaktuar në shkronjën "a" të pikës 1 të këtij neni, lëshohet nga Ministria e Mbrojtjes sipas procedurave dhe kritereve të posaçme të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Licencat e tjera, të përcaktuara në shkronjën "a" të pikës 1 të këtij neni, lëshohen nga Ministria e Mbrojtjes/struktura përgjegjëse sipas procedurave dhe kritereve të posaçme të përcaktuara nga legjislacioni i posaçëm në fuqi për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake.

4. Licencat e përcaktuara në shkronjat "b", "c", "ç", "d" dhe "dh" të pikës 1 të këtij neni lëshohen nga komisioni qendror në Policinë e Shtetit sipas procedurave dhe kritereve të posaçme të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 15

Licenca për import/eksport dhe tregtim për armët e kategorive "B1", "B4", "C" dhe "D"

(shfuqizuar me ligjin nr. 152/2020, datë 17.12.2020)

Neni 16

Licenca për transportin e armëve, pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre

(ndryshuar titulli, pika 1 dhe shtuar fjalë në pikat 2 e 3 me ligjin nr. 152/2020, datë 17.12.2020)

1. Licenca për transportin e armëve, pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre, që përfshihen në fushën e veprimit të këtij ligji, lëshohet nga organi përgjegjës i Policisë së Shtetit.

2. Licenca për transportin e armëve, pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre lëshohet në favor të çdo personi fizik apo juridik që plotëson kushtet dhe kriteret, sipas këtij ligji dhe akteve nënligjore, si dhe

të atyre që janë të licencuar më parë për veprimtari tregtare të import/eksportit të armëve.

3. Kushtet e sigurisë që duhet të plotësohen për veprimtarinë e transportit të armëve, pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre përcaktohen në rregulloren përkatëse të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 17

Licenca për poligon civil qitjeje të hapur, të mbyllur, me pjatel

(ndryshuar titulli, ndryshuar fjalatë në pikën 1 dhe ndryshuar pikat 3 e 4 me ligjin nr. 152/2020, datë 17.12.2020)

1. Licenca për poligon civil qitjeje, të hapur, të mbyllur, me pjatel, lëshohet nga organi përgjegjës i Policisë së Shtetit. Kjo licencë nënkupton të drejtën e mbajtjes së armëve vetëm gjatë ushtrimit të qitjes në poligon civil.

2. Poligoni civil i qitjes ndërtohet vetëm për qëllime rekreative, sportive ose të praktikës me shënjestër.

3. Në poligonin civil të qitjes, të hapur ose të mbyllur, lejohet mbajtja dhe përdorimi i armëve të kategorive “B” dhe “C”, ndërsa në poligonin civil të qitjes me pjatel lejohet vetëm mbajtja dhe përdorimi i armëve të gjahut.

4. Kushtet e sigurisë për ndërtimin dhe mënyrën e funksionimit të një poligoni civil qitjeje, si dhe kushtet dhe rregullat që duhet të plotësojë licenca për poligonin civil të qitjes të hapur, të mbyllur, me pjatel, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 18

Licenca për aftësimin teorik dhe praktik të personave për armën

1. Licenca për aftësimin teorik dhe praktik të personave për armën lëshohet nga organi përgjegjës i Policisë së Shtetit në favor të subjekteve të interesuara për ushtrimin e veprimtarisë së aftësimin teorik e praktik me armën.

2. Subjekteve të pajisura me licencë, sipas pikës 1, të këtij neni, u njihet e drejta e hapjes së kurseve private të trajnimit për aftësimin teorik dhe praktik të personave për armën dhe për dhënie dëshmie.

3. Personi fizik që kërkon të regjistrohet në kursin e trajnimit për aftësimin teorik dhe praktik me armën duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara në nenin 34 të këtij ligji.

4. Programi i kursit të trajnimit për aftësimin teorik dhe praktik për armën dhe kushtet që duhet të plotësojë objekti ku zhvillohet programi miratohen me udhëzim të ministrit.

Neni 18/1

Licenca për çaktivizimin e armëve të zjarrit për përdorim civil

(shtuar me ligjin nr. 152/2020, datë 17.12.2020)

1. Për veprimtarinë e çaktivizimit të armëve të zjarrit, që përfshihen në fushën e veprimit të këtij ligji, lëshohet licencë nga komisioni përgjegjës në Policinë e Shtetit.

2. Licenca për këtë veprimtari i jepet çdo personi fizik ose juridik, që plotëson kushtet dhe kriteret sipas këtij ligji dhe akteve nënligjore. Procesit të çaktivizimit i nënshtrohen armët në pronësi të personit fizik ose juridik, me kërkesën e tyre, për t’i mbajtur në pronësi si relike.

3. Standardet dhe teknikat e çaktivizimit për të garantuar që të gjitha pjesët kryesore të këtyre armëve të zjarrit të bëhen përfundimisht jofunksionale dhe të pamundura për t’u hequr, zëvendësuar ose modifikuar, në një mënyrë të tillë që do të mundësonte riaktivizimin e mundshëm të armëve të zjarrit, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Për kontrollin e çaktivizimit të armëve të zjarrit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit ngrihet dhe funksionon Komisioni i Kontrollit të Armëve të Vogla dhe të Lehta, për të garantuar që modifikimet e kryera në armët e zjarrit i bëjnë të gjitha pjesët kryesore të tyre përfundimisht jofunksionale dhe të pamundura për t'u hequr, zëvendësuar ose modifikuar. Ky komision lëshon vërtetim për armën e zjarrit të çaktivizuar dhe të markuar.

Neni 18/2

Licenca për tregtimin e armëve të kategorisë “B” dhe për import dhe tregtim të armëve të gjahut, sportive, pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre

(shtuar me ligjin nr. 152/2020, datë 17.12.2020; ndryshuar titulli, shtuar pika 1.1 dhe zëvendësuar fjalë në pikën 2 me ligjin nr.75/2023, datë 14.9.2023)

1. Për veprimtarinë e importit dhe tregtimin e armëve të gjahut, sportive, pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre, që përfshihen në fushën e veprimit të këtij ligji, lëshohet licencë nga komisioni përgjegjës në Policinë e Shtetit.
- 1.1 Për veprimtarinë e tregtimit të armëve të kategorisë “B”, pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre, që përfshihen në fushën e veprimit të këtij ligji, lëshohet licencë nga komisioni përgjegjës në Policinë e Shtetit.
2. Licenca për këto veprimtari i jepet çdo personi fizik ose juridik, që plotëson kushtet dhe kriteret sipas këtij ligji dhe akteve nënligjore.
3. Kushtet dhe rregullat që duhet të plotësojë subjekti për këtë veprimtari përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 19

Kritere e përgjithshme të licencimit

(ndryshuar fjalë në pikën 1 dhe shtuar 5 e 6 me ligjin nr. 152/2020, datë 17.12.2020; shtuar fjalë në pikën 1 me ligjin nr. 75/2023, datë 14.9.2023)

1. Kriteret e përgjithshme të licencimit, për licencat e transportit, tregtimit, poligonit dhe aftësimit teorik e praktik, janë këto:
 - a) subjekti juridik të jetë i regjistruar si subjekt tregtar dhe të ketë selinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
 - b) subjekti të ketë të përcaktuar drejtuesin teknik, i cili të jetë pajisur më parë me certifikatën përkatëse dhe të plotësojë kriteret për mbajtje arme, sipas kuptimit të këtij ligji.
2. Licenca lëshohet për një afat 5-vjeçar, me të drejtë ripërtëritjeje.
3. Procedurat e hollësishme të shqyrtimit të kërkesave, dokumentacioni, afatet e shqyrtimit dhe kriteret e veçanta të licencimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
4. Miratimi në heshtje nuk zbatohet në rastin e këtyre licencimeve.
5. Kriteret për licencat e parashikuara për çaktivizimin e armëve të zjarrit për përdorim civil, importin dhe tregtimin e armëve të gjahut, sportive, pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre, sipas këtij ligji janë si më poshtë:

a) subjekti të jetë i regjistruar si subjekt fizik ose juridik dhe ta ketë selinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

b) drejtuesi ose i punësuar në veprimtarinë e tregtimit të armëve të gjahut dhe pjesëve kryesore e municioneve duhet të jetë i pajisur me dëshmi për aftësimin teorik dhe praktik për armën nga subjekti që kryen kursin e trajnimit, sipas këtij ligji;

c) drejtuesit për çaktivizimin e armëve të zjarrit për përdorim civil duhet të jenë specialistë të armatimit, të diplomuar në shkolla ushtarake ose të trajnuar e pajisur me certifikatë nga Policia e Shtetit si specialistë për çaktivizimin e armëve të zjarrit për përdorim civil.

6. Procedura e certifikimit dhe formati i certifikatës miratohen me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Neni 19/1

Procedurat dhe kontrolli i importit të armëve të gjahut dhe sportive

(shtuar me ligjin nr. 152/2020, datë 17.12.2020)

1. Importimi i armëve të gjahut dhe sportive, pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre, sipas dispozitave të këtij ligji, kryhet me autorizim përkatës, të lëshuar në përputhje me formularin e miratuar nga drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit. Ky autorizim lëshohet nga komisioni përgjegjës në Policinë e Shtetit.

2. Nëse armët e gjahut dhe sportive, pjesët kryesore dhe municionet e tyre gjenden në një ose më shumë shtete të ndryshme nga ai ku është bërë aplikimi për autorizim importi, ky fakt duhet të paraqitet në aplikimin në fjalë. Policia e Shtetit, ku është bërë aplikimi për autorizim importi, konsultohet menjëherë me autoritetet kompetente të shtetit ose të shteteve të tjera.

3. Para lëshimit të autorizimit për importin e armëve të gjahut dhe sportive, pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre, Policia e Shtetit verifikon që:

a) vendi eksportues të ketë autorizuar importin përkatës;

b) vendet e treta të tranzitit, nëse ka, të kenë njoftuar me shkrim, të paktën para dërgesës, se nuk kanë asnjë kundërshtim në lidhje me tranzitin. Kjo dispozitë nuk zbatohet për dërgesat në rrugë ajrore ose detare dhe përmes porteve ose aeroporteve të vendeve të treta, me kusht që të mos ketë ndryshim të mjeteve të transportit dhe në rastin e eksporteve të përkohshme për qëllime të ligjshme të verifikueshme, të cilat përfshijnë gjuetinë, qitjen sportive, vlerësimin, ekspozimet pa shitje dhe riparimet.

Neni 19/2

Autorizimi i importit dhe eksportit të armëve të gjahut dhe sportive

(shtuar me ligjin nr. 152/2020, datë 17.12.2020)

Për qëllime gjurmimi, autorizimi për eksport dhe licenca e importit ose autorizimi i importit, si dhe dokumentacioni shoqërues duhet të përmbajnë së bashku informacionet që përfshijnë:

a) datën e lëshimit dhe skadimit të certifikatës;

b) vendin e lëshimit;

c) vendin e eksportit;

ç) vendin e importit;

d) sipas rastit, vendin ose vendet e treta të tranzitit;

dh) marrësin;

e) përdoruesin fundor, nëse dihet në kohën e dërgesës;

ë) të dhënat që mundësojnë identifikimin e armëve të zjarrit, pjesëve dhe të komponentëve kryesorë të tyre dhe municioneve, si dhe sasinë e tyre, duke përfshirë të paktën para dërgimit markimin e vendosur në armët e zjarrit.

Neni 19/3

Transferimi i përkohshëm i armëve dhe i municioneve të tyre

(shtuar me ligjin nr. 152/2020, datë 17.12.2020)

Procedurat e thjeshtuara për eksportin e përkohshëm ose riekportin e armëve të zjarrit, pjesëve dhe komponentëve kryesorë të tyre, si dhe municioneve, zbatohen si më poshtë:

a) Policia e Shtetit pajis me autorizim të përkohshëm për import dhe eksport gjuetarët ose qitësit sportivë, si pjesë e objekteve të tyre personale shoqëruese, gjatë një udhëtimi në një shtet të tretë ose hyrjes në Republikën e Shqipërisë;

b) autorizimi jepet me kusht që subjektet e përmendura në shkronjën “a” t’u vërtetojnë autoriteteve kompetente arsyet e udhëtimit, bashkëlidhur ftesën ose një provë tjetër të aktiviteteve të gjuetisë apo aktiviteteve sportive në vendin e tretë të destinacionit, për:

- i. një ose më shumë armë zjarri;
- ii. pjesët kryesore të tyre, të cilat janë të markuara;
- iii. municionet që lidhen me aktivitetin, me një kufizim prej maksimumi 800 fishekë për gjuetarët dhe maksimumi 1200 fishekë për qitësit sportivë.

Neni 19/4

Tranzitimi i armëve të zjarrit, i pjesëve përbërëse dhe i municioneve të tyre

(shtuar me ligjin nr. 152/2020, datë 17.12.2020)

Tranzitimi i armëve të zjarrit, i pjesëve përbërëse dhe i municioneve të tyre, në rrugë tokësore ose ujore, nga dogana/pika e hyrjes deri në doganë/pikën e daljes realizohet bazuar në licencën e lëshuar nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve.

Neni 20

Dëshmia për aftësimin teorik dhe praktik për armën

1. Dëshmia vërteton aftësimin teorik e praktik të personit që kërkon të pajiset me autorizim për mbajtje arme dhe lëshohet nga subjektet e licencuara më parë për këtë qëllim nga organi përgjegjës i Policisë së Shtetit.

2. Procedurat për dhënien, revokimin e dëshmisë, si dhe formati i saj përcaktohen me udhëzim të ministrit.

Neni 21

Drejtuesi teknik

1. Drejtuesi teknik është funksioni më i lartë teknik i subjektit të pajisur me licencë për të gjitha veprimtaritë e lejuara me armët, për drejtimin, menaxhimin, kontrollin e kësaj veprimtarie.

2. Certifikata për drejtues teknik lëshohet nga organi përgjegjës i Policisë së Shtetit.

3. Kanë të drejtë të aplikojnë për t'u pajisur me certifikatën e drejtuesit teknik të subjektit të gjithë shtetasit që janë me arsim policor e ushtarak, me vjetërsi shërbimi jo më pak se pesë vjet dhe që plotësojnë kriteret e mbajtjes së armës, sipas këtij ligji.

Neni 22

Detyrimet e subjektit të licencuar

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, subjekti i licencuar duhet të përmbushë këto detyrime:

- a) të paguajë detyrimet financiare që lidhen me ushtrimin e kësaj veprimtarie ndaj organeve shtetërore në afatën e përcaktuar, sipas legjislacionit në fuqi;
- b) të mos e përdorë licencën në kundërshtim me objektin e veprimtarisë së miratuar;
- c) të fillojë veprimtarinë brenda 180 ditëve nga hyrja në fuqi e licencës;
- ç) të mos transferojë armë dhe municione të subjekteve që nuk janë të pajisura me autorizim/licencë përkatëse nga organi përgjegjës;
- d) të raportojë në organin përgjegjës të policisë për aktivitetin mujor që kryen brenda datës 10 të muajit pasardhës;
- dh) të mbajë evidenca të plota për veprimtarinë që kryen, me të dhëna për personat, armët dhe municionet. Për këto regjistrime duhet të jetë në çdo moment i mundshëm inspektimi nga organi përgjegjës. Format i regjistrimit miratohet me udhëzim të ministrit;
- e) të marrë masat e plota për sigurimin teknik të armëve dhe municioneve, me qëllim parandalimin e aksidenteve, ngjarjeve të mundshme, lëvizjes, administrimit, ruajtjes e shitblerjes së tyre;
- ë) të përmbushë brenda afateve të caktuara detyrat e lëna me shkrim, pas inspektimit të kryer nga organi përgjegjës i Policisë së Shtetit;
- f) të mos e transferojë veprimtarinë, për të cilën është lëshuar licenca, te një subjekt tjetër;
- g) të kujdeset për certifikimin nga organi përgjegjës të personelit që punëson për ushtrimin e veprimtarisë së licencuar;
- gj) të mos punësojë në veprimtarinë e tij persona të pacertifikuar, sipas kuptimit të këtij ligji;
- h) të paraqesë dokumentet e shitblerjes në organin përgjegjës vendor të Policisë së Shtetit ku ai ushtron aktivitetin, brenda pesë ditëve nga shitblerja e armëve të zjarrit.

Neni 23

Inspektimi

(ndryshuar me ligjin nr. 152/2020, datë 17.12.2020)

1. Ushtrimi nga personat fizikë dhe juridikë i veprimtarisë së licencuar/autorizuar i nënshtrohet inspektimit të rregullt nga organi përgjegjës i Policisë së Shtetit, gjatë të cilit zbatohen dispozitat e ligjit për inspektimin në Republikën e Shqipërisë dhe dispozitat e tjera të zbatueshme në fuqi.

2. Policia e Shtetit inspekton subjektet fizike e juridike dhe mbikëqyr përmbushjen e detyrimeve ligjore, përfshirë masat e sigurisë, shitjen dhe blerjen e armëve, pjesëve kryesore e municioneve, trajnimin dhe pajisjen e personave fizikë me dëshminë e aftësimit teorik e praktik të armëve, mbajtjen e regjistrave, shitjen e municioneve, rregullat e regjistrimit të shtetasve në poligone.

3. Personat fizikë dhe juridikë të autorizuar/licencuar janë të detyruar të mundësojnë kryerjen e mbikëqyrjes, të kontrollit të armëve dhe municionit, të vendosin në dispozicion dokumentacionin përkatës dhe të ofrojnë të dhënat dhe njoftimet e nevojshme. Kjo përfshin të drejtën e organit kompetent të lejohet të hyjë në ambientet ku kryhet aktiviteti me armë, pjesë të armëve dhe municionit.

KREU IV
E DREJTA DHE KRITERET E MBAJTJES SË ARMËS

Neni 24

Llojet e autorizimeve

(shfuqizuar shkronja "ç" e pikës 1 me ligjin nr. 152/2020, datë 17.12.2020)

1. Në kuptim të këtij ligji, autorizimet që lëshon organi përgjegjës i Policisë së Shtetit janë:

- a) autorizim për blerje arme;
- b) autorizim për mbajtje arme;
- c) autorizim për përdorim skenik të armës;
- ç) Shfuqizuar;
- d) autorizim për koleksionim armësh.

2. Autorizimi për mbajtjen e armës ndahet në:

- a) autorizim për mbajtjen e armës së zjarrit në shërbim dhe në lëvizje;
- b) autorizim për mbajtjen e armës së zjarrit në vendbanim;
- c) autorizim për mbajtjen e armës së ftohtë në vendbanim;
- ç) autorizim i posaçëm për mbajtje arme;
- d) autorizim për mbajtje arme gjahu, sportive dhe armë të tjera të këtij lloji.

Neni 25

Autorizimi për blerje arme zjarri për personat juridikë

(ndryshuar fjalia e parë me ligjin nr. 152/2020, datë 17.12.2020)

Kanë të drejtë të pajisen me autorizim për blerje arme zjarri e municione përkatëse, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji, këta persona juridikë:

- a) subjektet e licencuara për shërbimin e sigurisë private;
- b) subjektet e licencuara për poligon civil qitjeje;
- c) autoriteti portual për sigurinë e porteve;
- ç) Banka e Shqipërisë për sigurinë e brendshme;
- d) subjektet që vërtetojnë qenien e tyre si koleksionistë;
- dh) subjektet juridike publike, të cilave me ligj të veçantë u jepet e drejta e mbajtjes së armës.

Neni 26

Autorizimi për blerje arme për personat fizikë

(shtuar fjali në fjalinë e parë, shtuar shkronja "d" dhe shfuqizuar pika 2 me ligjin nr. 152/2020, datë 17.12.2020)

1. Kanë të drejtë të pajisen me autorizim për blerje arme zjarri, sipas përcaktimeve të regjimit juridik për kategoritë e armëve të nenit 8, të këtij ligji, përkatësisht personat fizikë si më poshtë:

- a) ata që vërtetojnë qenien e tyre si koleksionistë;
- b) ata që u njihet e drejta e mbajtjes së armës me ligj të veçantë;
- c) ata që plotësojnë kriteret për pajisjen me autorizim, sipas nenit 34, të këtij ligji;
- ç) ata që, për shkak të veprimtarisë shtetërore ose të rrethanave personale të veçanta, janë të ekspozuar ndaj rrezikut për jetën dhe u njihet e drejta e mbrojtjes së veçantë, sipas legjislacionit në fuqi;
- d) qitësit sportivë dhe gjuetarët.

2. Shfuqizuar.

Neni 27

Autorizimi për mbajtjen e armës së zjarrit në shërbim dhe në lëvizje

(shtuar pika 5 me ligjin nr. 152/2020, datë 17.12.2020)

1. Autorizimi për mbajtje arme në shërbim nënkupton të drejtën e personit fizik për mbajtjen e armës gjatë kohës së punës vetëm në ambientet e punës apo të shërbimit.
2. Autorizimi për mbajtje arme në lëvizje nënkupton të drejtën e personit fizik për mbajtjen e armës, përveç sa parashikohet në pikën 1, të këtij neni, edhe jashtë qendrës së banimit apo të punës/shërbimit.
3. Në këto raste e drejta e përdorimit të armës rregullohet sipas ligjit në fuqi.
4. Në rastin e armës së gjahut dhe sportive autorizimi nënkupton të drejtën e mbajtjes së armës në lëvizje vetëm kur mbajtësi është pajisur me leje gjuetie apo leje si qitës profesionist sportiv.
5. Mbajtja e armëve për alarm, sinjalizim, pneumatike dhe paralizuesit elektrikë lejohet sipas qëllimit të caktuar në autorizim.

Neni 28

Autorizimi për mbajtje arme zjarri në vendbanim

1. Autorizimi për mbajtjen e armës së zjarrit në vendbanim nënkupton të drejtën e mbajtjes së saj vetëm në banesën e deklaruar si vendbanim, me kufizim të plotë për nxjerrjen e armës jashtë saj.
2. Në raste të tilla e drejta e përdorimit të armës rregullohet sipas ligjit në fuqi.
3. Lëshimi i autorizimit për mbajtjen e armës në kushtet e vendbanimit do të bëhet pasi të jenë verifikuar rregullat e sigurisë për ruajtjen e armës nga organi përgjegjës i Policisë së Shtetit.
4. Kushtet dhe rregullat e sigurisë për ruajtjen e armës së zjarrit në vendbanim përcaktohen në rregulloren e miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 29

Autorizimi për mbajtjen e armëve të ftohta

Organi përgjegjës i Policisë së Shtetit lëshon autorizim për mbajtjen në vendbanim të armëve të ftohta në favor të subjekteve që plotësojnë kriteret për pajisjen me autorizim, sipas nenit 34, të këtij ligji, me përjashtim të shkronjës “dh”.

Neni 30

Autorizimi i posaçëm për mbajtje arme

1. Kanë të drejtë të pajisen me autorizim të posaçëm për mbajtje arme personat fizikë që, për shkak të aktivitetit shtetëror ose të rrethanave personale të veçanta, janë të ekspozuar ndaj rrezikut për jetën dhe u njihet e drejta e mbrojtjes së veçantë, sipas legjislacionit në fuqi.
2. Procedurat për vlerësimin e kërcënimit të rrezikut për jetën përcaktohen me vendim Këshillit të Ministrave.

Neni 31

Autorizimi për mbajtje arme gjahu, sportive dhe armë të tjera

Autorizimi për mbajtje arme gjahu ose sportive, si dhe për armët e tjera, të ndryshme nga armët e zjarrit, që janë objekt i parashikimeve të këtij ligji e për të cilat kërkohet autorizim, jepet nga organi

përgjegjës i Policisë së Shtetit në favor të subjekteve:

- a) për të cilat e drejta e mbajtjes së armës parashikohet nga dispozitat ligjore të zbatueshme për gjuetinë;
- b) të cilat ushtrojnë në mënyrë profesionale apo amatore veprimtari që përfshihen në sportin e qitjes ose të praktikës me shënjestër;
- c) për të cilat e drejta e mbajtjes së armëve të tjera parashikohet në dispozita ligjore.

Neni 32

Autorizimet për përdorim skenik dhe për koleksionim armësh

(shtuar një fjali në pikën 1 dhe shtuar fjale në pikën 2 me ligjin nr. 152/2020, datë 17.12.2020)

1. Organi përgjegjës i Policisë së Shtetit lëshon autorizim për të mbajtur në përdorim skenik dhe kinematografik, kundrejt tarifës, armët e kategorive “A”, “B”, “C” dhe “D”. Për qëllime të përdorimit skenik dhe kinematografik, armët e zjarrit të kategorive “A”, “B”, “C” dhe “D”, kundrejt tarifës dhe me autorizim të organit përgjegjës të Policisë së Shtetit, mund të merren për këtë veprimtari edhe nga subjektet e licencuara për tregtimin e armëve në Republikën e Shqipërisë.

2. Transporti, sigurimi fizik, si dhe përdorimi i armëve për qëllime skenike e kinematografike bëhet nën mbikëqyrjen e punonjësve të Policisë së Shtetit ose të punonjësve të Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike të kontraktuar nga përdoruesi.

3. Autorizimi për koleksionim armësh lëshohet nga organi përgjegjës i Policisë së Shtetit në favor të subjekteve të njohura për këtë qëllim.

4. Për qëllim koleksionimi, lejohet mbajtja e jo më shumë se dy ekzemplarëve për çdo model arme.

5. Autorizimi për koleksionim armësh jepet pa afat.

Neni 33

Autorizimi për rimbushjen e municioneve

(shfuqizuar me ligjin nr. 152/2020, datë 17.12.2020)

Neni 34

Kriteret për t’u pajisur me autorizim

(ndryshuar shkrona “b”, “ç”, shtuar shkronjat “b/1”, “j” dhe shfuqizuar pika 4 me ligjin nr. 152/2020, datë 17.12.2020)

1. Personi që është përfitues i një prej llojeve të autorizimeve, sipas parashikimeve të këtij ligji, duhet të plotësojë këto kriteret:

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të ketë mbushur moshën 25 vjeç dhe të mos jetë mbi 70 vjeç në kohën e aplikimit për t’u pajisur me autorizim për mbajtje arme;
 - b/1) ndaj tij të mos jetë caktuar masë sigurie ose të mos jetë dënuar me vendim jopërfundimtar për kryerjen e krimeve të ndryshme;
- c) të mos ketë qenë i dënuar më parë me vendim të formës së prerë për vepra penale të kryera me dashje;
- ç) të mos ketë qenë i evidentuar për raste të kundërshtimit me dhunë ndaj punonjësve të Policisë së Shtetit, nëpunësit publik, për veprat penale të dhunës në familje, për çështje me objekt të hakmarrjes ose gjakmarrjes, si dhe për sjellje që cenojnë rendin dhe sigurinë në komunitet;
- d) të jetë i aftë nga ana fizike e mendore, si dhe të mos jetë përdorues i lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope, të vërtetuara këto me raportin mjekësor përkatës;

- dh) të zotërojnë dëshminë për kryerjen e kursit të aftësimit teorik dhe praktik për përdorimin e armës;
 - e) të mos jetë debitor në shlyerjen e gjobave për kundërvajtjet administrative të parashikuara sipas këtij ligji;
 - ë) të gëzojnë besueshmëri, në kuptim të këtij ligji.
 - f) të mos jetë revokuar licenca/autorizimi me një afat jo më të vogël se 3 vjet.
2. Procedurat, dokumentacioni dhe afatet e shqyrtimit për pajisjen me autorizim përcaktohen me udhëzim të ministrit.
3. Autorizimet e parashikuara në këtë ligj lëshohen për një afat pesëvjeçar, përveç rasteve ku është përcaktuar ndryshe.
4. Shfuqizuar.

Neni 35

Raporti mjekësor

(shtuar një fjalë në fund të pikës 1 dhe ndryshuar fjalë në pikën 2 me ligjin nr. 152/2020, datë 17.12.2020)

1. Kushdo që kërkon të blejë/mbajë një armë duhet të dëshmojë që nuk ka çrregullime fizike dhe/ose të shëndetit mendor, të pasqyruara këto në raportin periodik mjekësor, të lëshuar nga komisionet mjekoligjore. Përgjegjësi bëjnë punonjësit aktivë të strukturave shtetërore të armatosura.
2. Raporti mjekësor është i vlefshëm për një afat 6-mujor nga dita e dhënies dhe paraqitet në organin përgjegjës të Policisë së Shtetit në momentin e kërkesës së lëshimit ose të rinovimit të autorizimit për blerje ose mbajtje të armës.
3. Në kuptim të këtij ligji, çdo strukturë shëndetësore që vërteton çrregullime të shëndetit mendor të çdo shtetas, i cili raporton ose referon se është mbajtës i armës së zjarrit, detyrohet të njoftojë menjëherë organin përgjegjës vendor të policisë.
4. Administruesit e poligoneve, të cilët konstatojnë/dyshojnë, në vijim të sjelljeve jonormale të dyshimta, të hasura te çdo shtetas mbajtës i armës së zjarrit, se personi shfaq anomali të funksionimit fiziologjik dhe/ose mendor detyrohet të njoftojë menjëherë organin përgjegjës vendor të policisë.
5. Llojet e vizitave dhe përmbajtja e raportit mjekësor përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit dhe të Ministrit të Shëndetësisë.

Neni 36

Komisionet për dhënien e licencave, autorizimeve

1. Në Policinë e Shtetit ngrihen dhe funksionojnë këto komisione për dhënien e licencave dhe autorizimeve për veprimtaritë e lejuara me armë:
- a) komisioni qendror;
 - b) komisionet vendore.
2. Përbërja, detyrat dhe mënyra e funksionimit të këtyre komisioneve përcaktohen me urdhër të ministrit.

Neni 37

Përgjashtime nga rregullat e përcaktuara në autorizim

- Personi që është i pajisur me një nga autorizimet e dhëna nga Policia e Shtetit, sipas kuptimit të këtij ligji, përjashtohet nga detyrimet e vendosura për autorizimet dhe ka të drejtë të nxjerrë armën nga vendbanimi vetëm në këto raste:
- a) për shkak të detyrës së mbajtësit të autorizimit;

- b) për ushtrimin e veprimtarisë së gjuetisë gjatë sezonit të gjuetisë;
- c) për ushtrimin e veprimtarisë së qitjes sportive, pas lëshimit të autorizimit ditor nga Policia e Shtetit;
- ç) për shkak të kryerjes së shërbimeve teknike të riparimeve pranë subjekteve të autorizuar për këtë qëllim, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 38

Lëshimi i autorizimeve

(ndryshuar me ligjin nr. 152/2020, datë 17.12.2020)

1. Kërkesa për lëshimin e autorizimit për blerje dhe mbajtje arme, që përfshihen në kategoritë “B”, “C” dhe “D”, sipas këtij ligji, miratohet me akt administrativ të organeve përgjegjëse të Policisë së Shtetit.
2. Autorizimi për mbajtje arme zjarri lëshohet nga struktura vendore e policisë me afat 5-vjeçar, sipas formatit të miratuar, kundrejt pagesës së tarifës.
3. Personat që mbajnë autorizime për armë zjarri të kategorisë “B”, të parashikuara në këtë ligj, nuk kanë nevojë të aplikojnë për autorizim blerje për armët e kategorisë “C” dhe “D”, por pajisen me autorizim blerje nga komisioni përgjegjës pas kërkesës së personit në strukturën përgjegjëse të Policisë së Shtetit.
4. Autorizimet e parashikuara në këtë ligj rishikohen periodikisht, por jo para mbarimit të afatit 5-vjeçar, përveç autorizimit të posaçëm për mbajtje arme zjarri, i cili lëshohet nga drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, me afat vlefshmërie bazuar në vlerësimin e ekzistencës së kërcënimit dhe rrezikut për jetën.
5. Personat fizikë për nevoja të sigurisë fizike kanë të drejtë të pajisen vetëm me një armë zjarri të shkurtër gjysmautematike dhe me 50 fishekë për armë.
6. Personat fizikë për nevoja të gjuetisë kanë të drejtë të pajisen me një armë gjahu:
 - a) me vjaska;
 - b) gjysmautematike;
 - c) me përsëritje;
 - ç) çifte;
 - d) teke.
7. Personat fizikë, që kërkojnë të pajisen me armë mbi numrin e lejuar në pikën 6 të këtij neni, detyrohen të paguajnë pesëfishin e vlerës së tarifës të përcaktuar me udhëzim të përbashkët të ministrit dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë.
8. Personat fizikë, që ushtrojnë qitjen sportive, kanë të drejtë të pajisen me jo më shumë se dy armë për çdo model, sipas përcaktimit të nenit 8 të këtij ligji.
9. Personat fizikë të autorizuar si koleksionistë kanë të drejtë të pajisen me jo më shumë se dy armë për çdo model, sipas përcaktimit të nenit 8 të këtij ligji.
10. Subjektet e shërbimit privat të sigurisë fizike kanë të drejtë të blejnë me të njëjtin autorizim armë dhe 50 fishekë për armët e shkurtra dhe 100 fishekë për armë të gjata.
11. Armët e kategorive “B” dhe “C” dhe “D”, sipas këtij ligji, të cilat u dhurohen shtetasve që plotësojnë kriteret e këtij ligji, regjistrohen dhe administrohen sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 39

Tjetërsimi në kushtet e përdorimit vetjak të armës

(ndryshuar me ligjin nr. 152/2020, datë 17.12.2020)

1. Subjekteve të licencuara për tregtim u lejohe t'u shesin armët e zjarrit, pjesët e armës dhe municione vetëm personave fizikë dhe juridikë, të pajisur me autorizim të vlefshëm nga organi përgjegjës i Policisë së Shtetit.

2. Çdo transferim i mëtejshëm i armëve të zjarrit të kategorisë "C" u lejohe vetëm personave të pajisur me autorizim blerje nga komisioni përgjegjës në Policinë e Shtetit për këtë kategori armë zjarri, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Shitja e armëve të zjarrit midis personave fizikë dhe juridikë, të pajisur me autorizim për mbajtje arme/licence, dhe subjekteve me autorizim për blerje arme bëhet me kontratë të vërtetuar tek noteri, e cila përmban llojin, markën, numrin e serisë dhe kalibrin e armës, të dhënat e personit shitës dhe blerës, që përfshihen në autorizimin për mbajtjen e armës/licencës dhe autorizimin e blerjes. Regjistrimi dhe çregjistrimi i armës së zjarrit bëhet brenda 5 (pesë) ditëve në organin përgjegjës të Policisë së Shtetit, në juridiksion territorial, duke kryer edhe procedurat e dërgimit të formularit të balistikës nga organi përkatës i policisë vendore në Policinë Shkencore.

4. Këmbimi i armëve të zjarrit midis personave fizikë/juridikë, të pajisur me autorizim për mbajtje arme/licencë, kryhet në organin e policisë vendore ku është regjistruar njëra armë, duke deklaruar me shkrim nga dy pronarët, pa akt noterial. Pas dorëzimit të deklarimeve ata kryejnë regjistrimin, secili në organin përkatës të policisë vendore.

5. Blerja dhe shitja e armëve të gjahut të kategorisë "C" lejohe vetëm me autorizim brenda ose jashtë vendit. Shitja e armëve të gjahut një shtetasi të huaj bëhet me kusht që blerësi të jetë i pajisur me autorizim dhe dokumente identifikuese, të përkthyer e të noterizuara. Kur kryhet një transferim i tillë, organi përgjegjës i policisë përkatëse lëshon një leje transferimi, e cila e shoqëron armën e gjahut deri në mbërritjen në destinacion. Arma e zjarrit duhet të shoqërohet me një dokument, i cili përfshin të gjitha të dhënat e përmendura në pikën 3 të këtij neni. Për transferimin e armës njoftohet vendi pritës, sipas adresës së autorizimit për blerje.

6. Ndalohet shitblerja e armëve, pjesëve të armës dhe municionit nga personat fizikë dhe juridikë përmes rrjeteve elektronike.

Neni 40

Mbajtja e armës nga autoritetet e huaja

(shtuar shkronja "ë" në pikën 1 me ligjin nr. 152/2020, datë 17.12.2020)

1. Të drejtën për t'u pajisur me autorizim për mbajtje arme, mbi bazën e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe parimit të reciprocitetit, e kanë edhe personat e autoritetet e huaja si më poshtë:

- a) diplomatë të huaj, nëpunës të konsullatave dhe persona të huaj të barazuar në funksion me ta;
- b) punonjësit e misioneve ushtarake të huaja, të vendosura në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- c) personat, të cilët kanë për detyrë mbrojtjen e mjeteve të transportit ajror dhe të anijeve detare;
- ç) misionet e ndryshme policore e ushtarake, të akredituara në Republikën e Shqipërisë, për sigurimin personal ose të objekteve (rezidencave) të tyre me roje policore të brendshme që janë sjellë nga vetë ata;
- d) shtetasit e huaj që vijnë në Republikën e Shqipërisë për veprimtari sportive të qitjes dhe të gjuetisë sipas marrëveshjeve reciproke ndërshtetërore;

dh) subjekte të tjera, për të cilat e drejta e mbajtjes së armës parashikohet nga një marrëveshje ndërkombëtare ose dispozitë ligjore;

e) personeli i sigurimit të objekteve, personeli i përfaqësive diplomatike, shtetas shqiptarë të punësuar mbi bazën e kontratës së punës me këto autoritete, që plotësojnë kriteret, sipas këtij ligji, për mbajtje arme.

ë) punonjësit e misioneve policore të huaja për zhvillimin e operacioneve të përbashkëta me Policinë e

Shtetit në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Autorizimi për personat e përmendur në pikën 1, të këtij neni, përmban të dhënat përkatëse të personit dhe të armës, për të cilën lëshohet autorizimi.

3. Për hyrjen dhe daljen e armëve nga territori shtetëror, si dhe transportin brenda vendit, në favor të subjekteve të përmendura në pikën 1, të këtij neni, lëshohet autorizim, i cili mund të marrë formën e një akti të vetëm administrativ, të lëshuar së bashku me autorizimin e mbajtjes së armës.

Neni 41

Përgjegjësia për ruajtjen, përdorimin dhe raportimin

(ndryshuar pika 5 dhe shtuar pikat 6, 7, 8 dhe 9 me ligjin nr. 152/2020, datë 17.12.2020)

1. Personi që mban me autorizim armë të çdo lloji mban përgjegjësi, sipas dispozitave të këtij ligji, Kodit Civil dhe Kodit Penal, në rast përdorimi të armës nga persona të tretë.

2. Personi që është i pajisur me armë të çdo lloji është i detyruar të zbatojë rregullat për sigurimin fizik të armës në vendin e punës, në banesë dhe gjatë transportit.

3. Ndalohet përdorimi i armës jashtë destinacionit të saj. Qitja me armë zjarri lejohet vetëm në poligonet ose në vendet e caktuara për këtë qëllim, me masa sigurie.

4. Ndalohet mbajtja e armës së zjarrit nga çdo person fizik, të cilit i është dhënë e drejta për t'u pajisur, sipas kuptimit të këtij ligji, në raste tubimesh, manifestimesh, aktiviteteve kulturore, sportive e fetare, në ambiente publike dhe jashtë orarit zyrtar të detyrës së tij.

5. Për të minimizuar rrezikun që armët e zjarrit dhe municionet të përdoren nga persona të paautorizuar, personat që janë autorizuar të mbajnë armë ose municione, kanë detyrimin për mbikëqyrjen e duhur të armëve të zjarrit dhe municioneve, si dhe rregullave për ruajtjen e duhur në mënyrë të sigurt.

6. Armët e zjarrit dhe municionet e tyre nuk ruhen së bashku, por mbahen veçmas. Arma e shkurtër ruhet me kyç bllokimi, duke mos qenë lehtësisht e aksesueshme.

7. Personi që disponon në mënyrë të ligjshme armën e zjarrit ose municionin në fjalë, detyrohet të kryejë mbikëqyrjen e saj dhe të kontrollojë veprimet gjatë mbajtjes, transportit ose përdorimit.

8. Niveli i shqyrtimit të imtësishëm i këtyre masave të ruajtjes duhet të pasqyrojë numrin dhe kategorinë e armëve të zjarrit dhe municioneve në fjalë.

9. Kriteret e sigurisë së armëve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 42

Pushimi i së drejtës për mbajtje arme

1. Kur personat që janë përfitues të autorizimeve, sipas këtij ligji, largohen nga detyra ose kur nuk ekziston më rrethana tjetër, në bazë të së cilës u konsideruan përfitues, u pushon vetiu e drejta për mbajtjen e armës dhe detyrohen që, brenda tri ditëve, ta dorëzojnë atë në organin përgjegjës të Policisë së Shtetit.

2. Organi përgjegjës i Policisë së Shtetit, që ka për detyrë të administrojë armën e hequr, sipas përcaktimit në këtë ligj, e mban armën:

- a) deri në lëshimin sërish të autorizimit për zotëruesin e armës;
- b) deri kur të vërtetohet transferimi, sipas ligjit, i armës te një person tjetër që zotëron autorizim.

Neni 43

Trajtimi i armëve provë materiale

(ndryshuar pika 2 dhe shtuar pikat 2/1 dhe 2/2 me ligjin nr. 152/2020, datë 17.12.2020)

1. Të gjitha armët e zjarrit provë materiale, që janë pjesë e procesit të të provuarit në fazën e hetimeve paraprake a në gjykim, ose për të cilat është marrë një vendim i formës së prerë, i nënshtrohen regjimit, sipas parimeve të përgjithshme të Kodit të Procedurës Penale për disponimin e provave materiale.

2. Armët e zjarrit, pjesët kryesore dhe municionet, sipas pikës 1 të këtij neni, ato të grumbulluara me ligj nga Policia e Shtetit, të gjetura në terren, si dhe armët stok nga ristrukturimi i armatimit të Policisë së Shtetit, Ministrisë së Drejtësisë, Shërbimit Informativ të Shtetit i kalojnë Ministrisë së Mbrojtjes, me urdhër të përbashkët të titullarëve të autoriteteve përgjegjëse dhe ministrit të Mbrojtjes.

2/1. Ministrisë së Mbrojtjes, për armët, pjesët kryesore dhe municionet e tyre, të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, i lejohej të kryejë procedura të demilitarizimit, asgjësimit të tyre dhe shitjes për skrap. Procedurave të demilitarizimit, asgjësimit dhe shitjes për skrap u nënshtrohen edhe armët e gjetura nëpër hotspote nga strukturat e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

2/2. Pavarësisht përcaktimeve të pikës 3 të këtij neni, ministri i Mbrojtjes me urdhër mund të vendosë ruajtjen e armëve të caktuara, të cilat kanë vlera muzeale.

3. Agjencive të zbatimit të ligjit nuk u lejohej të përdorin armët e zjarrit provë materiale, të sekuestruara ose konfiskuara me vendim gjykatë të formës së prerë.

Neni 44

Disponimet për armët

1. Kur merret vendim për revokimin e autorizimit të lëshuar për armët, personit i jepet e drejta për të realizuar tjetërsimin e saj brenda 6 muajve nga data e marrjes dijeni të vendimit.

2. Me mbarimin e këtij afati, organi përgjegjës i Policisë së Shtetit ia dërgon titullin ekzekutiv të revokimit të autorizimit të mbajtjes së armës strukturës së përmbarimit të ekzekutimit të vendimit, e cila realizon tjetërsimin e armës nëpërmjet procedurave të ankandit publik.

3. Procedurat dhe rregullat për disponimet për armët në rastet e deklarimit të vdekjes, deklarimit të mbylljes ligjore të aktivitetit, për qëllime studimore, të humbjes së armës, vjedhjes së saj apo dokumentit/autorizimit që i njeh të drejta mbi të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 45

Armët e koleksionit

(ndryshuar pika 6 me ligjin nr. 152/2020, datë 17.12.2020)

1. Armët e koleksionit, në varësi të dispozitave ligjore në fuqi për trashëgiminë kulturore, mund të jenë objekte të trashëgimisë kulturore materiale të luajtshme.

2. Armët e zjarrit me vjaska të kategorive “A”, “B” dhe “C”, të cilat nuk janë objekt i ligjit për trashëgiminë kulturore, lejohen të mbahen të paaftësuar plotësisht ose pjesërisht. Kur arma nuk është e paaftësuar, për këto armë jepet autorizim nga organi përgjegjës i Policisë së Shtetit, ndërsa kur arma është e paaftësuar, bëhet vetëm regjistrimi i tyre.

3. Armët e koleksionit ruhen në muze ose në mjediset e caktuara nga personat fizikë e juridikë që janë zotërues të tyre, me të drejtën e municioneve mësimore të çaktivizuara.

4. Zotëruesit e armëve në muzetë publikë e privatë paraqesin, në organin përgjegjës të Policisë së Shtetit, 30 ditë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, në mënyrë periodike, listën e armëve të koleksionit që janë në zotërim ose në ruajtje të tyre, apo që synojnë t'i përfshijnë në koleksion në periudhën në vazhdim.

5. Për koleksionin e armëve, përfshirë edhe rastin e objekteve të trashëgimisë kulturore, që plotësojnë

kriteret për t'u konsideruar si armë, në kuptim të këtij ligji, organi përgjegjës i Policisë së Shtetit lëshon autorizimin përkatës në favor të institucionit ose personit që kryen ruajtjen e tij.

6. Armët e koleksionit që përbëjnë objekte të trashëgimisë kulturore, si dhe armët e shpallura pasuri kulturore u nënshtrohen parashikimeve të legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore, sa u përket ruajtjes, mbrojtjes, vlerësimit dhe administrimit të tyre.

7. Rregullat e hollësishme dhe procedurat e deklarimit, ruajtjes, regjistrimit dhe paafëtimit për armët e koleksionit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 46

Mbledhja e të dhënave personale

1. Organet përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji mund të mbledhin të dhëna personale nga institucionet dhe subjektet e tjera publike e private, në rastet kur administrimi i së dhënës përkatëse është i nevojshëm për qëllimet e lëshimit të licencave dhe autorizimeve të parashikuara në këtë ligj.

2. Të njëjtat të dhëna mund të mbledhen edhe pa pëlqimin e subjektit të së dhënës, në rast shqyrtimi të rrethanave, me qëllim revokimin e licencës/autorizimit, apo për shkak se të dhënat fillestare të deklaruara nuk janë të rregullta.

3. Gjatë veprimtarisë së mbledhjes, administrimit dhe përpunimit të të dhënave zbatohen dispozitat në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

4. Organet përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji, që vihen në dijeni me të dhënat personale, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit. Këto të dhëna nuk përhapen, përveç rasteve të parashikuara në këtë ligj.

Neni 47

Evidentimi i të dhënave për armët

1. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit zbaton dispozitat në fuqi për bazat e të dhënave shtetërore, lidhur me të dhënat për armët, licencat, autorizimet, blerësit, zotëruesit dhe ish-zotëruesit e armëve.

2. Personat fizikë dhe juridikë, të licencuar sipas dispozitave të këtij ligji, mbajnë evidenca të sakta e të hollësishme, në formë të shkruar dhe elektronike, për të gjitha veprimtaritë e lejuara dhe të kryera me armët.

Neni 48

Tarifat financiare

1. Aplikimi për lëshimin e licencave dhe autorizimeve, sipas dispozitave të veçanta të këtij ligji, kryhet kundrejt pagesës së tarifave për shërbimin administrativ dhe tarifës vjetore të mbajtjes së armës.

2. Në rast lëshimi të licencës apo autorizimit, subjekti përkatës paguan tarifën e licencimit/autorizimit në afatin e caktuar nga organi përgjegjës për lëshimin e titullit. Mospagimi i tarifës sjell revokimin e titullit, sipas dispozitave të këtij ligji.

3. Masa, kriteret dhe procedura për tarifat financiare përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit dhe të Ministrit të Financave.

KREU V

MASAT SHTRËNGUESE

Neni 49

Llojet e masave shtrënguese

1. Në kuptim të këtij ligji, për shkeljet e konstatuara jepen këto masa shtrënguese:
 - a) pezullim i licencës dhe i autorizimit;
 - b) revokim i licencës dhe i autorizimit.
2. Masat shtrënguese për veprimtaritë e lejuara me armë jepen nga komisionet përkatëse të Policisë së Shtetit, sipas kompetencave dhe juridiksionit.

Neni 50

Pezullimi i licencës

1. Organi përgjegjës i Policisë së Shtetit, si rregull, urdhëron ripërmbyshjen e kushteve apo ndreqjen e shkeljeve të detyrimeve, brenda 30 ditëve, pa pezullim të titullit ose pezullimin e titullit për një afat të arsyeshëm, deri në zbatimin e urdhrit për ripërmbyshjen e kushteve apo ndreqjen e shkeljeve të detyrimeve, përpara marrjes së vendimit për revokimin e licencës. Ky parashikim nuk zbatohet në rastet e parashikuara në shkronjat “b” dhe “c”, të nenit 51, të këtij ligji, për të cilat revokimi i licencës bëhet automatikisht.
2. Pa cenuar zbatimin e procedurave paraprahe, të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, pezullimi vendoset ndaj titullarit të saj në këto raste:
 - a) kur titullari humbet kriteret e licencimit, të parashikuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore të dala në zbatim të tij;
 - b) kur konstatohet se titullari, në dokumentacionin e dorëzuar, ka paraqitur të dhëna të pasakta ose të rreme;
 - c) me kërkesë të titullarit për të hequr dorë nga licenca;
 - ç) kur titullari nuk përmbush, sipas ligjit, detyrimin për pagimin e gjobës së vënë si masë administrative.
3. Urdhri i pezullimit revokohet nga organi përgjegjës kur vlerësohet se titullari i ka plotësuar të gjitha urdhërimet, sipas rastit.

Neni 51

Revokimi i licencës

(shtuar shkronja “ç” me ligjin nr. 152/2020, datë 17.12.2020)

- Organi përgjegjës i Policisë së Shtetit revokon licencën në këto raste:
- a) kur rrethanat janë të tilla që s’do të kishte kuptim ose mundësi për ripërmbyshjen e kushteve apo ndreqjen e shkeljes së detyrimeve nga titullari, brenda çdo afati të arsyeshëm pezullimi;
 - b) në rast moszbatimi të urdhërimeve brenda afateve të arsyeshme të pezullimit;
 - c) në rastin e shkeljeve të rënda me faj nga titullari dhe/ose kur shkelja ka shkaktuar dëmtim të interesit publik, që garantohet nga titulli përkatës apo legjislacioni në fuqi.
 - ç) me kërkesë të titullarit për të hequr dorë nga licenca.

Neni 52

Pezullimi i autorizimit

1. Organi përgjegjës i Policisë së Shtetit ka të drejtë të pezullojë autorizimin për mbajtjen e armës kur:
 - a) shkelen rregullat për mbajtjen, sigurimin dhe përdorimin e armës;

- b) arma mund të përdoret si mjet për kryerjen e një vepre penale;
 - c) titullari pushon së përmbushuri kriteret për pajisjen me autorizim;
 - ç) për rrethana të tjera që cenojnë të drejtën e titullarit për ta pasur në vazhdim këtë status;
 - d) kryhen veprime verifikuese për mbajtësin dhe armën e tij.
2. pezullimi i autorizimit për mbajtje arme bëhet me vendim, brenda 30 ditëve nga data e konstatimit të shkeljes, me përjashtim të rasteve kur afati është i lidhur me daljen e një akti të një institucioni tjetër.

Neni 53

Revokimi i autorizimit për mbajtje arme

(shtuar shkronja “ç” me ligjin nr. 152/2020, datë 17.12.2020)

1. Në kuptim të këtij ligji, revokimi i autorizimit për mbajtje arme bëhet në këto raste:
 - a) kur nuk zbatohen urdhërimet brenda afateve të arsyeshme të pezullimit;
 - b) në rastin e ndryshimeve të kriterëve të përgjithshme për pajisjen me autorizim, sipas ligjit në fuqi;
 - c) për rrethana që cenojnë të drejtën e titullarit për ta pasur në vazhdim këtë status.
 - ç) kur nxjerr armën nga vendbanimi pa autorizim.
2. Revokimi mund të bëhet edhe pa aplikuar më parë urdhërimet apo pezullimin, kur shkelja është në kushtet e flagrancës dhe ka sjellë pasoja të rënda.

Neni 54

Ankimi administrativ

1. Ndaj akteve të pezullimit dhe revokimit të licencës mund të bëhet ankim, brenda 30 ditëve nga data e marrjes njoftim, pranë Drejtorit të Përgjithshëm Policisë së Shtetit.
2. Ndaj akteve të pezullimit dhe revokimit të autorizimit lejohet ankim, brenda 30 ditëve nga marrja njoftim, pranë drejtuesit të organit përgjegjës vendor të Policisë së Shtetit.
3. Shqyrtimi i ankimeve bëhet sipas rregullave të përgjithshme, të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative.

Neni 55

Ankimi në gjykatë

Ndaj vendimeve të autoriteteve, të përcaktuara në nenin 54, të këtij ligji, mund të bëhet ankim në gjykatën administrative, sipas dispozitave të ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

KREU VI

SANKSIONE ADMINISTRATIVE

Neni 56

Kundërvajtjet administrative

1. Personat fizikë dhe juridikë, që veprojnë në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij, kur veprimet e tyre përkatëse nuk përbëjnë vepër penale, janë përgjegjës për kundërvajtje administrative.
2. Dënohen me gjobë prej 30 000 (tridhjetë mijë) deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë personi juridik dhe me gjobë 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) deri në 80 000 (tetëdhjetë mijë) lekë personi fizik, kur:
 - a) e mban, e përdor armën në kundërshtim me qëllimin e caktuar në autorizimet e dhëna nga Policia e

Shtetit dhe agjencitë e zbatimit të ligjit;

b) nuk paraqitet në afatin e caktuar për procedurën e regjistrimit të armës së blerë, armës së koleksionit, pranë organit përgjegjës të Policisë së Shtetit;

c) shkel rregullat e caktuara për ruajtjen fizike të armës në banesë, vendin e punës dhe gjatë transportit;

ç) shkel rregullat në evidentimin, dorëzimin, ruajtjen e armëve në cilësinë e provës materiale;

d) shkel rregullat e caktuara në rast zhdukjeje, humbjeje, vjedhjeje të armës ose të dokumentit që njeh të drejta mbi të;

dh) nuk paraqitet për të bërë njoftimin, në rast ndryshimi të vendbanimit, dhe nuk bën dorëzimin e armës së zjarrit në organin vendor të Policisë së Shtetit;

e) nuk paraqitet për dorëzimin e armës, në rastet e humbjes së të drejtës për mbajtje të saj;

ë) pas vdekjes së mbajtësit, anëtarët e familjes nuk zbatojnë rregullat për disponimet për armët;

f) nuk kryen apo kryen me mangësi mbajtjen e regjistrave/evidencës së armëve dhe të veprimeve të kryera me to;

g) nuk vë në dispozicion të organit përgjegjës kërkues të dhënat përkatëse të nevojshme për lëshimin apo revokimin e licencës/autorizimit për personin subjekt i të dhënave.

3. Për shkeljet e përmendura në shkronjat “a”, “dh” dhe “ë”, të kësaj pike, personi dënohet, gjithashtu, me masën plotësuese të konfiskimit të armës.

4. Me gjobë nga 100 000 (njëqind mijë) deri në 200 000 (dyqind mijë) lekë dënohet personi juridik ose fizik, i cili:

a) shkel rregullat e parashikuara për shitjen dhe shkëmbimin e armëve të zjarrit;

b) nuk fillon ushtrimin e veprimtarisë së licencuar në afatin e caktuar nga dispozitat ligjore në fuqi;

c) pa lejen e organit përgjegjës kthen sërish në gjendje pune armën e paaftësuar më parë ose shkel dispozitat e tjera ligjore në fuqi për trajtimin e armëve të paaftësuar;

ç) transporton armë në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, nuk merr masat e përcaktuara në ligj për siguri gjatë transportit.

Për shkeljet e përmendura në pikën 4, të këtij neni, organi përgjegjës shtetëror, në raport me shkallën e fajësisë, krahas dënimit kryesor, jep dhe masa plotësuese, atë të ndalimit të ushtrimit të veprimtarisë përkatëse, në afat nga një deri në tre vjet, dhe të konfiskimit të armëve.

5. Me gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë dënohet personi fizik ose juridik, i cili:

a) shkel kushtet dhe kërkesat e zbatueshme për veprimet juridike në lidhje me armët;

b) nuk njofton, raporton apo aplikon pranë organit përgjegjës, sipas detyrimeve që rrjedhin nga rregullat në fuqi;

c) pengon ose nuk merr masat e nevojshme për të lejuar inspektimin, nga organi përgjegjës, të veprimtarisë që ushtrohet nga subjekti me licencë/autorizim;

ç) shkel kushtet dhe kërkesat për ushtrimin e veprimtarisë së licencuar/autorizuar;

d) kryen shkelje të rregullave të caktuara për ushtrimin e veprimtarisë së aftësimit teorik dhe praktik të personave fizikë, kërkues të autorizimit për mbajtje arme;

dh) shkel rregullat e caktuara në tregtimin e brendshëm të armëve ose në procedurat e eksportit dhe importit të armëve, që janë objekt i rregullimeve të këtij ligji;

e) shkel rregullat e caktuara për mbajtjen, sigurimin, përdorimin e armëve në poligonet e licencuara, poligonet e qitjes sportive, në gjueti.

Për shkeljet e përmendura në këtë pikë, në përputhje me rrezikshmërinë e pasojat e ardhura nga shkelja, personi mund të dënohet, sipas rastit, edhe me masat plotësuese, atë të ndalimit të ushtrimit të veprimtarisë përkatëse, në afat nga gjashtë muaj deri në dy vjet, dhe të konfiskimit të armëve.

6. Organi përgjegjës i Policisë së Shtetit konstaton dhe shqyrton shkeljet administrative në përputhje

me kriteret dhe procedurat përkatëse, sipas ligjit nr. 10 279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative”.

Neni 56/1

Autoritetet kompetente për dhënien e masave

(shtuar me ligjin nr. 152/2020, datë 17.12.2020)

1. Masat administrative, sipas neneve 52, 53, 56, pikat 2 dhe 3, jepen nga drejtori vendor i Policisë së Shtetit.

2. Masat administrative, sipas neneve 50, 51, 56, pikat 4 dhe 5, jepen nga drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

KREU VII

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 57

Dispozitë kalimtare

1. Tetëmbëdhjetë muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, lejet dhe aktet e tjera administrative që japin të drejta mbi armët, të lëshuara sipas kriterëve, formës dhe procedurave që nuk vijnë në përputhje me ligjin e ri për armët dhe të akteve nënligjore, të dala në zbatim të tij, humbasin fuqinë juridike me vendim të organit përgjegjës shtetëror. Përpara mbarimit të këtij afati, subjektet e interesuara për përtëritjen e akteve administrative të mëparshme aplikojnë për lëshimin e akteve të reja, sipas dispozitave të këtij ligji. Akti i ri që lëshohet i shtrin efektet kohore deri në mbarimin e afatit të aktit të mëparshëm dhe lëshohet pa zbatuar detyrimet financiare të përmendura në këtë ligj.

2. Brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji, zotëruesit e armëve dhe muzetë publikë e privatë, që administrojnë armë të fituara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, paraqesin në organin përgjegjës të Policisë së Shtetit listën e armëve të koleksionit që janë në zotërim a në ruajtje të tyre, ose që synojnë t'i përfshijnë në koleksion në periudhën në vazhdim.

3. Brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të gjitha subjektet që ushtrojnë veprimtari të tregimit të armëve të ftohta deklarojnë, regjistrojnë dhe aplikojnë për pajisjen me aktin administrativ përkatës pranë organit përgjegjës vendor të Policisë së Shtetit.

Dispozitë kalimtare

(vendosur me ligjin nr. 152/2020, datë 17.12.2020)

1. Karakteristikat grupore, llojet dhe parametrat teknikë të armëve të ftohta, për të cilat organi kompetent lëshon autorizim për mbajtjen nga shtetasit, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Licencat e lëshuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji janë të vlefshme deri në përfundimin e afatit të përcaktuar.

3. Autorizimi për mbajtje arme, i lëshuar para hyrjes në fuqi të këtij ligji, për shtetasin mbi 70 vjeç, është i vlefshëm. Shtetasi që ka mbushur moshën 70 vjeç rinovon autorizimin për mbajtjen e armës çdo tre vjet.

Neni 58

Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 9, pika 7, 10, pika 3, 14, shkronja “d”, 15, pika 3, 16, pika 3, 17, pika 4, 19, pika 3, 28, pika 4, 30, pika 2, 44, pika 3, dhe 45, pika 7, të këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike që, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 11, pika 2, 18, pika 4, 20, pika 2, 22, shkronja “dh”, 34, pika 2, dhe 36, pika 2, të këtij ligji.

3. Ngarkohen ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike dhe Ministri i Shëndetësisë që, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrin udhëzimin në zbatim të nenit 35, pika 5, të këtij ligji.

4. Ngarkohen ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike, Ministri i Mbrojtjes dhe Prokurori i Përgjithshëm që, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrin udhëzimin në zbatim të nenit 43, pika 2, të këtij ligji.

5. Ngarkohen ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike dhe Ministri i Financave që, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrin udhëzimin në zbatim të nenit 48, pika 3, të këtij ligji.

Neni 59 Shfuqizime

Ligji nr. 99/2013, “Për armët”, shfuqizohet.

Neni 60 Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 10.7.2014

**KRYETARI
Ilir Meta**